BASHKIA
SHKODËR

# P4. Shërbimet Publike

**"Shkodra, me njerëzit kreativ, historinë e kulturën, mikpritjen e burimet natyrore, një komunitet që jeton e zhvillohet, derë e hapur për integrim”**

## Përmbajtja

**P4. Shërbimet Publike 3**
1. Hyrje 3
2. Politikat e zhvillimit 3
3. Funksionet: 3
3.1. F1. Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane 3
3.1.1 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1. 7
3.2. F2. Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike 7
3.2.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O1. 8
3.3. F3. Prodhimi, trajtimi, transmetimi dhe furnizimi me ujë të pishëm. 8
F3.O1. Furnizimi me uje te pijshem injesive administrative te Bashkise Shkodër 8
3.3.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F3.O1 9
3.4. F4. Mbledhja, largimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura 9
3.4.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F4.O1 10
3.5. F5. Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara. 10
3.5.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F5.O1 11
3.6. F6.Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike si dhe garantimi i shërbimit të varrimit; 11
3.6.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F6.O1. 12
3.7. F7. Shërbimin e dekorit publik 13
3.7.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F7.O1 13
3.8. F8. Ndriçimi i mjediseve publike 13
3.8.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F8.O1 15
3.9. F9. Shërbime publike vendore 16
3.9.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F9.O1 16
4. Buxhetimi i programit të Shërbimeve Publike 16
5. Projektet dhe aktivitetet e planifikuara për Sherbimet Publike 17

## P4. Shërbimet Publike

### 1. Hyrje

Programi i ofrimit të shërbimeve publike qytetarëve, bizneseve dhe të gjithë komunitetit në të gjithë territorin administrative të bashkisë përbën një nga kolonat kryesore të programit buxhetor.

Ky program përmban shërbimet më jetike për komunitetin siç janë:

a) mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane,
b) mirëmbajtja dhe administrimi i sipërfaqeve të gjelberta,
c) mirëmbajtja e varrezave publike dhe krijimi i kushteve sipas standartave për shërbimin funeral ,
d) prodhimi, trajtimi, transmetimi dhe furnizimin me ujë të pijshëm,
e) mbledhja, largimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura,
f) mbledhja dhe largimi i ujërave të shiut dhe mbrojtja nga përmbytjet në zonat e banuara,
g) shërbimi i dekorit publik dhe ndriçimi i mjediseve publike,
h) mobiliteti dhe transporti nëpërmjet krijimit të lehtësirave të lëvizjes, krijimin e kushteve për transportin publik,
i) mirëmbajtja e rrugëve urbane dhe rurale si dhe realizimi sipas standarteve të sinjalistikës rrugore.

Shërbimet publike, për nga rëndësia e tyre, ndikojnë direkt në cilësinë e jetesës së qytetarëve dhe janë një parakusht për zhvillimin social ekonomik për të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër.

### 2. Politikat e zhvillimit

Programi i shërbimeve publike, bazohet në tre politika themelore :

Ofrimi i shërbimeve publike cilësore për përmirësimin e jetesës së qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit.

Rritja e e efiçensës dhe efektivitetit të shërbimeve publike, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjisë si dhe zgjerimit të shërbimit.

Rritja e transparencës në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, duke siguruar pjesëmarrjen e publikut në proçesin e planifikimit dhe te monitorimit, për ta orientuar atë sipas nevojave të tyre.

### 3.1. F1. Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane

**F1.O1. Përmiresimi i cilësisë së shërbimit, menaxhimi i mbetjeve të ngurta duke filluar ndarjen në burim të atyre të riciklueshme nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe edukimit mjedisor, që bën të mundur përmiresimin e situatës mjedisore dhe reduktimin e sasisë së mbetjeve që depozitohet në landfill.**

**Situata e vleresuar/e pritshme ne fund te vitit 2017:**

- Mbledhje, transport dhe depozitim i mbetjeve për qytetin dhe 8 Njësi Administrative; (1+3)
  - 178 pika grumbullimi në Shkodër qytet
  - 380 pika grumbullimi në NjA;
- Për herë të parë e gjithë sasia rreth 38,760 ton/vit mbetje të transportuara e të depozituara në landfill.
- Numri i familjeve përfituese të shërbimit të pastrimit në të gjithë Bashkinë është rreth 30,930.
- Numri i bizneseve dhe institucioneve përfituese është 5,500.
- Frekuenca e shërbimit të pastrimit në qytet, në 90% të territorit kryhet një herë në ditë, ndërsa në pjesën tjetër kryhet 2 herë në ditë, në akset kryesore afër bizneseve.
- Frekuenca e shërbimit të pastrimit në Nj.A është 2-3 herë në javë ndërsa në Nj.A të Velipojës gjatë sezonit turistik është 2 herë në ditë.
- Nevojë për informimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për shërbimin publik të menaxhimit të mbetjeve.
- Për një performancë më të mirë të shërbimit është përmirësuar sistemi i monitorimit. Përveç supervizorëve të ngarkuar inspektorët e lagjeve raportojnë çdo ditë në bazë te grafikëve dhe planeve të evakuimit dhe pastrimit të mbetjeve dhe rrugëve të parashikuara pjesë e kontratës së shërbimit.
- Po punohet për hartimin e planit te menaxhimit të mbetjeve për gjithë Bashkinë, në bashkëpunim me organizatën dldp.

**Situata e synuar 2018** **Situata e synuar 2019** **Situata e synuar 2020**

- **Zgjerim i shërbimit në territor;**
- **Uljen e kostos së transportit;**
- **Përdorimin me efiçiencë të mjeteve;**
- **Llogaritje më e mirë e normës së prodhimit të mbetjeve për cdo njësi, për familje dhe biznese, referuar historikut të të dhënave dhe përllogaritjeve që marrin në konsideratë vendosjen e popullsisë, dhe bizneseve.;**
- **Shtim i pikave të grumbullimit;**
- **Shtim i kontenierëve;**
- **Përmirësimin e sigurisë në rrugë përmes krijimit të hapësirës së përshtatshme për vendosjen e pikave të grumbullimit;**
- **Zbatim i sistemit të monitorimit të shërbimit në mënyrë më të automatizuar në të gjithë territorin;**
- **Sensibilizim i popullatës për shërbimin, ruajtjen e mjedisit, bashkëpunimin për një qytet të pastër;**
- **Përmirësimin e sigurisë në rrugë përmes krijimit të hapësirës së përshtatshme për vendosjen e pikave të grumbullimit;**

**Përmirësim i shërbimit të pastrimit në të gjitha njësitë administrative**

**A:Rrethinat, Postribë,**

| | |
|---|---|
| **Shalë, Pult, Shosh, Guri i Zi:**<br><br>**-3 mjet 10 ton/ 1 turne (mjeti i trete mund të merret 5ton për rrugët e ngushta);**<br><br>**Numri i pikave/kontenierëve shtohen 232 - (Total 497)**<br><br>**Rritje e frekuencës me 2.5 herë/javë** | |
| **Ana Malit, Bërdicë, Velipojë, Dajç:**<br><br>**-3 mjet 10 ton/ 1 turne (mjeti i trete mund të merret 5ton për rrugët e ngushta);**<br><br>**Numri i pikave/kontenierëve shtohen 100 (Total 243);**<br><br>**Rritje e frekuencës në 2.5 herë/javë;** | |
| **Velipojë Plazh:**<br><br>**- 2 mjete 5ton/2 turne;**<br><br>**Numri i pikave/kontenierëve shtohen 63 (Total 223);**<br><br>**Rritet freuenca në 7ditë/javë/2 herë/ ditë** | |
| **Shkodër:**<br><br>**- 4 +1 mjete 10 ton (mjeti reserve mund të jetë 5 ton për turnin e dytë në disa rrugë);**<br><br>**Numri i pikave/kontenierëve** | |

| | | |
|---|---|---|
| **shtohen 150 (Total 759);**<br><br>**7ditë/javë;**<br><br>**Fshirja mekanike:**<br>**1 mjet fshirje mekanike: 2 herë/javë;**<br>**Mjeti 5 ton për rrugicat e ngushta (Shkodër): Shtohen konteniere 10 (Total 24); 7ditë/ditë.** | | |
| **1,326 biznesetë mëdha përfitojnë nga shërbimi i pastrimit.**<br>**4409 Biznese të vogla dhe institucione përfitojnë nga shërbimi i pastrimit;** | | |
| **35,425 familje (sipas censusit) përfitojnë nga shërbimi i pastrimit;**<br>**37 % e kostos së shërbimit mbulohet nga familjet. Këtu janë hequr familjet me lehtësi fiskale dhe është llogaritur kapaciteti i plotë.** | | |
| **Kostoja e plotë e shërbimit mbulohet 85 % nga të ardhurat nga tarifa, dhe 15% e kostos së mbetur mbulohet nga transferta e pakushtëzuar.** | | |
| **Sasia e mbetjeve të grumbulluara në të gjitha Nj.A e Bashkisë Shkodër dhe të transportuara në landfill do të jetë mesatarisht 4500 ton/muaj e cila depozitohet e gjitha në landfillin Bushat.** | Sasia e mbetjeve të grumbulluara në të gjitha Nj.A e Bashkisë Shkodër dhe të transportuara në landfillin Bushat do të jetë 4200 ton ne muaj. | Sasia e mbetjeve të grumbulluara në të gjitha Nj.A e Bashkisë Shkodër dhe të transportuara në landfill do të jetë 3900 ton ne muaj |

| | | |
|---|---|---|
| | Sasia e mbetjeve ngurta të grumbulluara nga ndarja në burim për riciklim në masën 1%, te sasise se grumbulluar | Sasia e mbetjeve ngurta të grumbulluara nga ndarja në burim për riciklim në masën 5%, te sasise se grumbulluar. |

### 3.1.1 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1.

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë 2018 | Buxheti në mijë lekë 2019 | Buxheti në mijë lekë 2020 |
|---|---|---|---|
| **P4.F1.O1.A1-A8. Shërbimi i Pastrimit** | **184,562** | **200,000** | **207,000** |

## 3.2. F2. Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike

**F2.O1 Përmirësimi i cilësisë së mirëmbajtjes dhe riorganizimi i lulishteve, zgjerimi i sipëfaqeve të gjelberta dhe gjelberimit rrugor, në të gjithë Bashkinë.**
**Situata e vleresuar/e pritshme ne fund te vitit 2017:**

- Gjatë vitit 2017 kemi realizuar mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta dhe të gjelbërimit rrugor.
- Shërbimi realizohet për mirëmbajtjen e 72 600 m2 sipërfaqe të gjelbër ,ku përfshihen 54 lulishte.Shërbimet për mirëmbajtjen e siperfaqes së barit, drurëve dekorativ, shkurreve, sipërfaqeve ujore, stolave, pastrim i rrugë të brendshme etj
- Sipërfaqja e gjelber në Nj.A Velipojë është rikualifikuar duke realizuar mbjelljen e 124 pemëve dekorative.
- Mirëmbahen në mënyrë të vazhdueshme gjithë drunjtë dekorativë të gjelbërimit rrugor.
- Në Bashkinë Shkodër ka nevojë për shtimin e hapësirave të gjelbra dhe shlodhëse.
- Shërbimi i gjelbrimit aktualisht realizohet në qytet dhe Nj.A Velipojë me sipërmarrje private;

  Çeshtjet që meritojnë vemendje:
- Dëmtimi i sipërfaqeve të lulishteve:
- Dëmtimi i stolave nga amortizimi, por edhe nga veprimet e qëllimshme nga persona të papërgjegjshem.
- Mungesa e infrastrukturës në lulishte për vendosjen e biçikletave.
- Mungesa e çesmave publike në lulishtet më tëfrekuentuara nga banorët.
- Pengesat nga parkingjet për realizimin e shërbimeve të pemëve në gjelbërimin rrugor.
- Ndotja e shatërvaneve shpesh nga papërgjegjëshmeria e qytetarëve që hedhin mbeturina në to.
- Planifikimi i ndërhyrjes për riorganizimin e hapësirave të gjelbërta, duke u mbeshtetur në kulturen dhe traditen e qytetit në kultivimin e bimëve tradicionale.

| Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 | Situata e synuar 2020 |
|---|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| **Fillimi i realizimit të shërbimit të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra , për të gjithë Bashkinë me sipërmarrje private, duke rritur sipërfaqet e gjelbërta për shërbim me 17 810 $m^2$ apo ndryshe, me 7 lulishte të reja , si dhe drurëve të gjelbërimit rrugor me 1200 copë.**<br>**Kryerje e një shërbimi në lulishte sipas tipologjive (A, B, C) të sipërfaqeve të gjelbra.**<br>**E njëjta gjë dhe për gjelbërimin rrugor, shërbim I vecantë për ato sipas lartësisë por edhe sipas rëndësisë, duke e ndarë në: gjelbërim rrugor standart dhe gjelbërim rrugor në rrugë historike.**<br><br>**1- Riorganizimi i sipërfaqeve të gjelbra në kuadër të përmisimit të peisazhit urban dhe historik , si dhe për të qenë funksionale për të gjithe komunitetin si dhe duke prezantuar me bimesi sipas traditës dhe kulturës së qytetit , trëndafila, lule vjolë, kadife,etj.**<br>**2- Ofrim i shërbimit të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta për të gjitha lulishtet e qytetit.**<br>**3- Krijimi i sipërfaqeve të reja të gjelbra, me investime.**<br>**4 - Zgjerim i gjelbrimit rrugor në Nj.A, sipas prioriteteve.**<br>**5- Shërbim periodik i mirëmbajtjes edhepër pika të rëndësishme turistike të qytetit, sirruga e Kalasë Rozafat, Bregu i liqenit dhe tek Ura e eMesit, sipas eventeve të ndyshme në këto dy zona.**<br>**6 - Mirëmbajtje e infrastruktures rrugore ne Nj.A , duke i pastruar nga bimësia e gjelbër.(shkurre, ferra, barëra të lartë.)**<br>**7 - Mirëmbajtje e bankinave të rrugëvedhe trotuareve duke i pastruar nga bimësi e gjelbërt (bari).** | Rritje e sipërfaqeve të gjelbërta në qytet dhe Njësi Administrative. | Rritje e sipërfaqeve të gjelbërta në qytet dhe Njësi Administrative. |

### 3.2.1.Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O1.

| **Aktiviteti** | **Buxheti në mijë lekë 2018** | **Buxheti në mijë lekë 2019** | **Buxheti në mijë lekë 2020** |
|---|---|---|---|
| **P4.F2.O1.A1. Shërbimi i Mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta** | **38,279** | **37,330** | **38,060** |

## 3.3. F3. Prodhimi, trajtimi, transmetimi dhe furnizimi me ujë të pishëm.

**F3.O1. Furnizimi me uje te pijshem injesive administrative te Bashkise Shkodër**

**Situata e vlerësuar/e pritshme në fund të vitit 2017:**

- 26,909 familje (76% në Shkodër qytet) furnizohen me ujë të pijshëm;
- 2,107 biznese furnizohen më ujë nga ujësjellësi;
- Gjatë stinës së dimrit, sasia e prodhuar e ujit është 650 litra/ sek kurse gjatë stinës së verës, sasia e prodhuar e ujit është 850 litra/sek;
- Rreth 78% e banorëve në NjA Shkodër furnizohen me ujë të pijshëm;
- Nga UK Shkodër është marrë në dorëzim në Prill të 2017 Stacioni i pompimit Trush dhe depot që furnizojnë me ujë Njësinë Administrative Velipoje;
- Tabela përmbledhese e sistemeve të marra në dorëzim dhe që operohen nga UK Shkodër:

| Vendodhja | Nr. Stacioneve të pompimit | Nr. Rezervuareve | Gjendja e rrjetit shpërndarës |
|---|---|---|---|
| Nj.A Bërdicë | 3 | 3 | Shumë i amortizuar |
| Zues | 1 | 1 | Shumë i amortizuar |
| Obot | 1 | 1 | Shumë i amortizuar |
| Zogaj | 1 | 1 | |
| Dajc | 4 | 4 | |
| Gur i zi | 1 | 1 | Shumë i amortizuar |
| Juban | 1 | 1 | Jashtë funksioni |
| Nj.A shalë | Vetrrjedhje | 4 | Investim i Ri |
| Dragoç i ri | Vetrrjedhje | | Investim i Ri |
| Mes-Meselin | 1 | 1 | Shumë i amortizuar |
| Drisht | 1 | 1 | Shumë i amortizuar |
| Oblikë | 1 | 2 | Shumë i amortizuar |
| Hot i ri | 1 | 1 | |
| Trush | 1 | 1 | |

| Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 | Situata e synuar 2020 |
|---|---|---|
| | | |

**Përmirësimi i indikatorëve të furnizimit të popullatës me ujë të pijshëm pa ndërprerje.**

**Rritja e aksesit të popullsisë urbane dhe rurale në furnizimin me ujë të pijshëm cilësore.**

**Zgjerimi i rrjetit të furnizimit me ujë të pishëm të popullatës në funksion të zhvillimi të infrastrukturës.**

**Përdorimi me eficencë i subvencioneve për kanalizimin e ujrave të bardha.**

### 3.3.1.Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F3.O1

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë 2018 | Buxheti në mijë lekë 2019 | Buxheti në mijë lekë 2020 |
|---|---|---|---|
| P4.F3.O1.A0-A3.Furnizimi me ujë i qytetit dhe Njësive Administrative. | 0 | 0 | 0 |

## 3.4. F4. Mbledhja, largimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura

**F4.O1.Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të zeza në të gjithë zonat urbane dhe Nj.A të bashkisë.**

**Situata e vlerësuar/e pritshme në fund të vitit 2017:**

- Rreth 22,176 familje janë të lidhur me rrjetin KUZ në Bashkinë Shkodër;
- 2,156 biznese janë të lidhura në sistemin e KUZ;
- Rrjeti i kanalizimeve të ujerave të zeza në qytet është rreth 150 km;
- Rreth 70 % e numrit të përgjithshëm të banorëve të qytetit Shkodër janë të lidhur me rrjetin KUZ. Kryesisht janë të pa lidhur me rrjetin KUZ zonat periferike të qytetit, të cilat funksionojnë me gropa septike;
- Në Bashkinë Shkodër ka 2 impiante të pastrimit të ujërat të zeza në Velipojë, dhe në Shirokë;
- Në Maj të vitit 2017, është bërë e mundur të fillohet procesi i inventarizimit të ITUP në Velipojë me shumë vështirësi dhe mungesë të një inventari përfundimtar mbi punimet e fazës së parë, të dytë dhe te trete. Në bazë të dokumentacionit që disponohet dhe sipas situacionit të datës 29.07.2015 (i dorëzuar në CD), janë konstatuar disa mangësi në zërat makineri dhe pjesë rezervë. Nuk kemi asnje informacion zyrtar apo dokumentacion të dorëzuar për orientimin drejt lidhjeve me kanalizimet e ujerave të ndotura, sipas fazave të projektit. Nisur nga këto problematika Ujësjellës Fshat nuk ka pranuar të bëhet pjesë e procesit të transferimit. Aktualisht këto dy sisteme me të gjitha mangësitë dhe vështirësitë e konstatuara, po punohet intensivisht për një operim dhe funksionim normal nga UK Shkodër.
- Stacioni i Shirokës i cili bën të mundur trajtimin e ujërave të përdorura që grumbullohen nga rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza të zonës turistike të Shirokës dhe i shkarkon në liqen është në eficencë të plotë dhe mirëmbahet në mënyrë të vazhdueshme nga UK Shkodër sh.a.

| Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 | Situata e synuar 2020 |
|---|---|---|
| Ofrimi i shërbimit të qëndrueshëm dhe funksional brenda standarteve nëpërmjet mirëmbajtjes së rrjetit të kanalizimit të ujrave të bardha duke synuar eleminimin e problematikave të përmbytjeve të zonave të veçanta. | | |
| Mirëmbatje e vazhdueshme të kanaleve të ujrave të bardha duke ndërhyrë në pastrimin e tyre. | | |
| Përdorimi me eficencë i subvencioneve për kanalizimin e ujrave të bardha. | | |

### 3.4.1.Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F4.O1

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë 2018 | Buxheti në mijë lekë 2019 | Buxheti në mijë lekë 2020 |
|---|---|---|---|
| P4.F4.O1.A1.Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të zeza në të gjithë zonat urbane dhe Nj.A të Bashkisë. | 0 | 0 | 0 |

## 3.5. F5. Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara.

**F5.O1.Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të ujrave të shiut në të gjithë zonat urbane dhe Nj.A të Bashkisë.**

**Situata e vlerësuar/e pritshme në fund të vitit 2017:**

- Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të bardha i qytetit të Shkodrës (për mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut) funksionon i ndarë nga rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza;
- Gjatësia e përgjithshme e sistemit të kanalizimeve të KUB për qytetin është rreth 54 km. Rreth 37 km përbëhen nga tubacione të mbyllura dhe pjesa tjetër janë kanale të hapura;
- Sistemi kryesor i drenazhimit mbulon rreth 70% të zonave formale të qytetit, ndërsa në zonat informale zë një mbulim shumë më të ulët.
- Gjatë vitit 2017 është kryer mirëmbajtje e vazhdueshme dhe e qëndrueshme e rrjetit KUB qytet:
  - Mirëmbajtje dhe pastrim i 3,800 ml kanale të mëdha kulluese në segmentet:
  - Mirëmbajtje KUB Tepe-Kir
  - Mirëmbajtje KUB Bahçallek-Bërdicë
  - Mirëmbajtje KUB Bahçallëk Bërdicë sekondari I i anës së rrugës,
  - Mirëmbajtje KUB Bahçallëk Bërdicë sekondari II;
  - Mirëmbajtje KUB Telekom-Kinema Millenium,
  - Mirëmbajtje KUB Ura Dervishbeg-Sheshi Isa Boletini,
  - Mirëmbajtje KUB Fusha e Druve-Bonifikime.
  - Pastrim i 15,000 ml kuneta dhe kanale që përbëjnë ngarkesën tipike gjatë një muaji në rrugët: Fahri Ramadani, Rr. Ura (kanal i hapur), Tepe (kanal i hapur).

| **Situata e synuar 2018** | **Situata e synuar 2019** | **Situata e synuar 2020** |
|---|---|---|
| **Ofrimi i shërbimit të qëndrueshëm dhe funksional brenda standarteve nëpërmjet mirëmbajtjes së rrjetit të kanalizimit të ujrave të bardha duke synuar eleminimin e problematikave të përmbytjeve të zonave të veçanta.** | | |
| **Mirëmbatje e vazhdueshme të kanaleve të ujrave të bardha duke ndërhyrë në pastrimin e tyre.** | | |
| **Përdorimi me efiçencë i subvencioneve për kanalizimin e ujrave të bardha.** | | |

### 3.5.1.Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F5.O1

| Aktivitetet | Buxheti në mijë lekë 2018 | Buxheti në mijë lekë 2019 | Buxheti në mijë lekë 2020 |
|---|---|---|---|
| **P4.F5.O1.A1Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të ujrave të shiut në të gjithë zonat urbane dhe Nj.A të Bashkisë.** | 15,000 | 15,000 | 15,000 |

## 3.6. F6.Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike si dhe garantimi i shërbimit të varrimit;

**F6.O1. Shërbim cilësor me standarte dhe sipas normativave të rregullores së mirëmbajtjes së Varrezave. Zgjerim i teritorit të Varrezave për vazhdimësinë e ketij shërbimi .**

**Situata e vlerësuar/e pritshme në fund të vitit 2017:**

- Mirëmbajtja e varrezave publike në qytet kryhet me sipërmarrje private që përgjithëson mirëmbajtjen e 62 312 $m^2$.
- Shërbimet që ofrohen janë:

Pastrim parcelash dhe rrugësh të mbrendëshme ndërmjet parcelave me sipërfaqe 52.312 m2
Mbjellje drurësh dekorativ 41 copë.
Mbjellje në parcela bordurë e gjelbert, 250 m2 .
Gjithashtu kryhet dhe shërbimi i ruajtjes për varrezat publike dhe ato të dëshmoreve.

- Mirëmbatja e varrezave publike në Nj.A administrohen që mirëmbahen nga vetë Nj.A dhe shoqatat që operojnë në këto njesi.
- Del nevojë hartimi i një rregullore për zbatim të ligjshmërisë për funksionimin dhe administrimin e varrezave publike

**Situata e Vlerësuar:**

- Nuk ka një Plan veprimi për përmirësimin e ofrimit të shërbimit publik të varrezave. Pjesë e shërbimit mungon një rregullore e përditësuar për ofrimin e shërbimit publik të varrezave.
- Shpesh ka vështirësi në administrimin sipas rregullores së funksionimit te varrezave publike, pasi varrezat nuk kanë shpesh rrethim të plotë.
- Ka lëvizje të mjeteve dhe këmbësorëve, ndonjëherë të pa kontrolluar , jo per marrjen e shërbimit ne varreza, por si rruge kalimi.
- Në pjesën më të madhe të njësive, administrimi i varrezave bëhet nga vetë banorët e fshatit apo nga institucione fetare.
- Bashkia Shkodër ka angazhuar punonjes të shërbimeve të varrezave të pajisur me mjete përkatëse për ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave në Njësitë administrative.
- Në ndonjë nga njësitë administrative pjesë e Bashkisë Shkodër, kërkohet vlerësimi dhe planifikimi per shpronësim të hapësirave të reja në funksione të shërbimit të varrezave.
- Nuk ka një tarifë të studiuar për shërbimin publik të varrimit.

| Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 | Situata e synuar 2020 |
|---|---|---|
| **Ofrim i shërbimit publik të varrezave në 80 % të territorit administrativ të Bashkisë Shkodër.<br>Vazhdim i ofrimit nëpërmjet kontratës me operatorin për Nja Shkodër deri në përfundim të afatit të kontratës.<br>Vazhdim i ofrimit të shërbimit në NJA, përmes punonjësve publikë të kontraktuar për këtë qëllim.<br>Gjatë vitit 2018, që në Janar Bashkia Shkodër do të fillijë punën për hartimin e planit të veprimit për të ofruar shërbim të standartizuar dhe me indikatorë të matjes së performancës për të gjithë territorin e Bashkisë së Shkodrës.<br>Për vitin 2018 e në vazhdim do të fuqizojë bashkëpunimin me komunitetin, institucionet e besimeve fetare për një mbarëvajtje komunitare të këtij shërbimi në te gjithë territorin.** | | |
| **Zgjerimi i sipërfaqes me parcela të reja për shërbimin funeral** | | |
| **Ruajtja dhe administrimi i varrezave në përputhje me kuadrin ligjor** | | |
| **Ofrimi i shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave ne Nj.A me punonjësit e vete Nj.A** | | |

### 3.6.1.Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F6.O1.

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë 2018 | Buxheti në mijë lekë 2019 | Buxheti në mijë lekë 2020 |
|---|---|---|---|
| **P4.F6.O1.A1-A3. Mirëmbajtje e varrezave publike dhe varrezave të dëshmorëve** | **10,009** | **10,009** | **10,009** |

## 3.7. F7. Shërbimin e dekorit publik

**F7.O1. Shtimi i aktiviteteve festive që kanë nevojë për dekorim, duke ruajtur traditën dhe kulturën tonë**

**Situata e vlerësuar/e pritshme në fund të vitit 2017:**

- Për vitin 2017 sektori i dekorit pranë shërbimeve publike ka realizuar punime mirëmbajtje dhe dekori me rastin e festave, eventeve të organizuara nga Bashkia Shkodër, organizata jo qeveritare dhe institucione fetare për projekte dhe evente të përbashkëta të organizuara.
- Në vitin 2017 është realizuar blerja e aksesorëve të tjerë që kanë bërë të munduar shtimin e sipërfaqeve të dekoruar për festat e fundvitit në sheshet kryesore dhe akset kryesore në qendër të qytetit.
- Është realizuar blerja e materiale të ndryshme për dekorin të nevojshme për riparimin e aksesorëve të blerë në vite;
- Është realizuar blerja e flamujve për dekorin e institucioneve administrative në të gjithë territorin si dhe në sheshe dhe rrugë kryesore.

| Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 | Situata e synuar 2020 |
|---|---|---|
| Krijimi i dekorit në të gjithë sheshet dhe rrugët kryesore në zonat urbane; | | |
| Krijimi i dekorit festiv me rastin e festave zyrtare dhe fetare | | |

### 3.7.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F7.O1

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë 2018 | Buxheti në mijë lekë 2019 | Buxheti në mijë lekë 2020 |
|---|---|---|---|
| **P4.F7.O1.A1 Dekorimi i mjediseve publike** | **1,971** | **2,000** | **2,000** |

## 3.8. F8. Ndriçimi i mjediseve publike

**F8.O1. Përmirësimi i menaxhimit të shërbimit të ndriçimit**

**Situata e vlerësuar/e pritshme në fund të vitit 2017:**

- Nëpërmjet shërbimit të mirëmbajtjes, rehabilitimit dhe investimeve është realizuar puna për rehabilitimin apo investime për ndriçim rrugor në 37 rrugë në Bashkinë Shkodër (26 në zonën urbane dhe 11 rrugë në NJA)
  - Ndriçimi i rrugës "Ali Spahija"
  - Ndriçimi i rrugës "Malo Hoxha"
  - Ndriçimi i rrugës "Hysen Lohja"
  - Ndriçimi i rrugës "Oroshej"
  - Ndriçimi i rrugës "Velej" segmenti II
  - Ndriçimi i rrugës "Zogaj"
  - Ndriçimi i rrugës "Muminit"

- Ndriçimi i rrugës “Zabelaj”
- Ndriçimi i rrugës “Ferrugaj”
- Ndriçimi i rrugës ”Anton Ballaci”
- Ndriçimi i rrugës “Vladimit Jani”
- Ndriçimi i rrugës “Ali Demi (Tepe)”
- Ndriçimi i rrugës “Banja e Vogël” *(Degëzim)*
- Ndriçimi i rrugës “Vllaznimi”
- Ndriçimi i rrugës “Arra e Madhe”*(Degëzim)*
- Kryqëzimi i “Dajçit” (Nj.A. Dajç)
- Rruga “Pentar” (Nj.A. Dajç)
- Rruga “Beltojë” (Nj.A. Berdicë)
- Rruga fshati “Drisht”(Nj.A. Postribë)
- Rruga fshati “Myselim”(Nj.A. Postribë)
- Rruga fshati “Grudë” (Nj.A. Rrethina)
- Rruga fshati “Bardhaj”*Degëzim*(Nj.A. Rrethina)
- Rruga Nr 2(NJ.A. Velipojë)
- Rruga fshati “Ganjollë”(Nj.A. Guri i Zi)
- Rruga ”Baja e vogël”, dëgëzim
- Rruga ”Mehmet Gjyli”, Draçin
- Rruga ”Populli”
- Rruga ”Sheuqet Muka”
- Rruga ”Qemal Draçini”, Degëzim;
- Rruga ”Shtëpia e Bujqëve”;
- Rruga ”Smakaj”
- Bulevardi ”Skënderbeg”, degëzim;
- Rruga ”Ali Pash Gucia”
- Rruga ”Sarda”
- Rruga ”Treni i Mallnave”
- Rruga ”Fshati Bërdicë”
- Rruga nr.3 Velipojë;

- Mirëmbajtja e gjithë rrjeti i ndriçimit publik në rrugë kryesore, dytësore në të gjithë Bashkinë:
  - 1,210,000 m2 sipërfaqe e ndriçuar e mirëmbajtur;
  - 38,000 m2 sipërfaqe e gjelbëruar e ndriçuar e mirëmbajtur
  - Mirëmbajtje e 4,640 ndriçuesve të zakonshëm;
  - Mirëmbajtje e 118 ndriçueve dekorativ;

- Realizimi i lidhjes të kontratave të reja në qytet dhe njësitë administrative për 35 rrugë të reja të ndriçuara gjatë vitit 2017;
- Realizimi i pageses për konsumin e pritshëm të energjisë elektrike (50, 000,000 lekë) për të gjitha kontratat në qytet dhe njësitë administrative;
- Realizimi i ndriçimit publik në 1,100 ml rrugë kryesore;
- Realizimi i ndriçimit publik në 4,100 ml rrugë dytësore të reja në qytet dhe në njësi administrative.
- Rritje e sipërfaqes së ndriçuar në qytet nga 1,210,000 m2 në në 1,241,200, nga 75 % sipërfaqe rrugësh e ndriçuar në rritjen në 77.7 % sipërfaqe e ndriçuar

| Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 | Situata e synuar 2020 |
|---|---|---|

| Hartim i planit të veprimit për përmirësimin e shërbimit të ndriçimit publik | Monitorim dhe përditësim i planit të veprimit për përmirësimin e shërbimit të ndriçimit publik | Monitorim dhe përditësim i planit të veprimit për përmirësimin e shërbimit të ndriçimit publik |
|---|---|---|
| **Sipërfaqja totale e rrugëve dhe e shesheve të ndriçuara nga 1,210,000 në 1,241,200 m2** | Sipërfaqja totale e rrugëve dhe e shesheve të ndriçuara nga 1,241,200 në 1,263,400 m2 | Sipërfaqja totale e rrugëve dhe e shesheve të ndriçuara nga 1,263,400 në 1,281,400 m2 |
| **Sipërfaqet e lulishteve të ndriçuara me investime të reja nga 38,000 në 40,000 m2. Rehabilitim dhe mirëmbajtje e ndriçimit të lulishteve ekzistuese.** | Sipërfaqet e lulishteve të ndriçuara me investime të reja nga 40,000 në 43,000 m2. Rehabilitim dhe mirëmbajtje e ndriçimit të lulishteve ekzistuese. | Sipërfaqet e lulishteve të ndriçuara me investime të reja nga 43,000 në 48,000 m2. Rehabilitim dhe mirëmbajtje e ndriçimit të lulishteve ekzistuese. |
| **Mirëmbajtje e ndriçuesve të zakonshëm nga 4,640 në 4,790** | Mirëmbajtje e ndriçuesve të zakonshëm nga 4,790 në 4,900 | Mirëmbajtje e ndriçuesve të zakonshëm nga 4,900 në 5,000 |
| **Ndërtim i ndriçimit publik në rrugë kryesore me 1,100 ml dhe rrugë dytësore me 1,100 ml** | Zgjerimi i rehabilitimi akeseve të tjera kryesore të qytetit me ndriçues LED. Ndërtim i ndriçimit publik në 700 ml rrugë dytësore po me ndriçues LED me reduktim kostoje | Zgjerimi i rehabilitimi akeseve të tjera kryesore të qytetit me ndriçues LED. Ndërtim i ndriçimit publik në 500 ml rrugë dytësore po me ndriçues LED me reduktim kostoje |
| **Ofrimi i shërbimit të mirëmbajtjes së ndriçimit në 7 Nj.A dhe ndërtimi i linjave të reja me prioritet zonat e populluara në 3,000 ml. Studimi për burime alternative për Nj.Administrative malore.** | Ofrimi i shërbimit të mirëmbajtjes së ndriçimit në 7 Nj.A dhe ndërtimi i linjave të reja me prioritet zonat e populluara në 3,000 ml. Studimi për burime alternative për Nj.Administrative malore. | Ofrimi i shërbimit të mirëmbajtjes së ndriçimit në 7 Nj.A dhe ndërtimi i linjave të reja me prioritet zonat e populluara në 2,500 ml. Studimi për burime alternative për Nj.Administrative malore. |
| **Kostoja e shërbimit të gjelbërimit mbulohet 32% me të ardhurat nga tarifa, dhe 68% nga transferta e pakushtëzuar.** | | |

### 3.8.1.Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F8.O1

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë 2018 | Buxheti në mijë lekë 2019 | Buxheti në mijë lekë 2020 |
|---|---|---|---|
| **P4.F8.O1.A1 Shërbimi i Sistemit të Ndriçimit Publik të Qytetit dhe Njësive Administrative** | **90,167** | **91,408** | **92,624** |

## 3.9. F9. Shërbime publike vendore

**F9.O1. Përmbushja e nevojës për kryerjen e shërbimeve ditore të ruajtjes, pastrimit, mirëmbajtjes dhe të tjera për objektet dhe hapësirat publike.**
**Situata e vlerësuar/e pritshme në fund të vitit 2017:**

Përmes funksionimit të njësisë së ofrimit të shërbimeve publike në Bashkinëë Shkodrës, punonjësit janë angazhuar në punë dhe:

- Është realizuar ofrimi i shërbimit të pastrimit në Nj.A.
- Është realizuar mbajtja në efiçencë rrjeti i ndriçimit publik në qytet dhe NjA.
- Është realizuar punime të mirëmbajtja sinjalistikës horizontale dhe vertikale.
- Është realizuar punime mirëmbajtje e objekteve në administrim të Bashkisë.
- Të tjera sipas nevojës për punë publike në territor.

| Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 | Situata e synuar 2020 |
|---|---|---|
| **Mbajtja në efiçencë të plotë te ndriçimit publik ekzistues, mirëmbajtja e sinjalistikës në të gjithë bashkinë.** | | |
| **Ofrimi i shërbimeve të rojës, pastrimit të objekteve, mirëmbajtjes së objekteve dhe të tjera në qytet dhe në NjA** | | |

### 3.9.1.Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F9.O1

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë 2018 | Buxheti në mijë lekë 2019 | Buxheti në mijë lekë 2019 |
|---|---|---|---|
| **P4.F9.O1.A1** Përmbushja e nevojës për kryerjen e shërbimeve ditore të ruajtjes, pastrimit, mirëmbajtjes dhe të tjera për objektet dhe hapësirat publike. | 33,517 | 33,919 | 34,993 |
| **P4.F9.O1.A2.** Hartimi i planeve të veprimit per sherbimet publike | 540 | | |

## 4. Buxhetimi i programit të Shërbimeve Publike

Për realizimin e aktiviteteve/projekteve të Shërbimeve Publike, planifikohet buxheti me vlerë totale 374,045 mijë lekë ndër të cilat 9% paga dhe sigurime shoqërore, 81 % shpenzime operative, 4% transferta dhe 6 % investime.

**Tabelë 1 Planifikimi për Sherbimet Publike**

| Programi P4 | Paga + Sigurime | Shpenzime Operative | Subvensioni | Transferta | Investime | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Plani 2017** | 20,635 | 257,916 | 0 | 5,180 | 48,355 | **332,086** |
| **Plani 2018** | 32,077 | 304,773 | 0 | 15,180 | 22,015 | **374,045** |
| **Plani 2019** | 33,739 | 316,490 | 0 | 15,180 | 24,257 | **389,666** |
| **Plani 2020** | 34,413 | 318,467 | 0 | 15,180 | 31,626 | **399,686** |




Grafik 1 Planifikimi i shpenzimeve për Sherbimet Publike

## 5. Projektet dhe aktivitetet e planifikuara për Sherbimet Publike

<table>
<tr><td>Nr.1</td><td>Projekti : P4.F1.O1.A1-A8<br><br>Sherbimi i pastrimit</td><td><u>Llojet e programit</u> : P4. Shërbimet Publike<br><br>Funksioni : P4.F1. Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane;</td></tr>
<tr><td colspan="3">a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</td></tr>
<tr><td colspan="3">i. Situata</td></tr>
<tr><td colspan="3">Gjatë vitit 2017 Bashkia Shkodër ka bërë të mundur administrimin dhe menaxhimin e shërbimit të pastrimit në 9 njësi administrative, përfshirë këtu edhe qytetin e Shkodrës. Kështu gjatë vitit 2017, ne bëmë një hap cilësor kur bëhet fjalë për zonën e mbulimit me shërbim, standartazimin e shërbimit, rregullimin e shërbimit, kostimin dhe përmirësimin e administrimit dhe monitorimin, sidomos në njësitë administrative.<br>Kujtojmë që përpara një viti ky shërbim jepej në mënyrë të qëndrueshme dhe sipas frekuencave të përcaktuara vetëm në Velipojë, Dajç, Guri i Zi, Shkodër, pra në 5 nga 11 njësitë administrative. Gjatë vitit 2016 në njësitë Bërdicë, Ana e Malit, Rrethinat, Postribë, Theth – Shalë ky shërbim është mundësuar me mjetet dhe burimet njerëzore që kemi patur në dispozicion.<br>Këtë vit zona e mbulimit është rritur, duke shtuar shërbimin e strukturuar me frekuenca të përcaktuara, sipas standartit të dakordësuar, me pika grumbullimi të përcaktuara dhe me kontenierë edhe në gjashtë njësitë e tjera që janë: Rrethina, Guri i Zi, Ana e Malit, Bërdicë,Theth-Shalë, dhe Postribë<br><br>Më saktësisht gjatë vitit 2017 shërbimi i pastrimit u organizua në 4 (katër) zona funksionale si më poshtë:</td></tr>
</table>

**A. ZONA FUNKSIONALE, territori që mbulon Njësitë Administrative Rrethinat, Postribë, Shalë**

Në 6-mujorin e parë të vitit për Njësitë Rrethinat, Postribë, Shalë, shërbimi u mbulua me mjetet në dispozicion të Bashkisë Shkodër si dhe me burimet financiare për punonjës shërbimi, naftë, dhe transport e depozitim në landfill të mbetjeve.

Në 6 – mujorin e dytë ky shërbimështë përmirësuar dukshëm duke u bërë mëi qëndrueshëm, sipas frekuencës së dakordësuar, me pika të grumbullimit të mbetjeve në secilën njësi dhe të shpërndara sipas nevojës që vetë banorët përcaktuan, bazuar në sasinë e mundshme në dispozicion të kontenienrëve të mbetjeve të investuar nga Bashkia Shkodër.

Shërbimi në këtë zonën funksionale **Rrethinat, Postribë, Shalë, aktualisht** realizohet si më poshtë:

- Mjetet që përdoren janë *2 mjete 10 ton + 1 mjet i hapur 5 ton.*
- Frekuenca e lëvizjes së mjeteve:
  - ✓ *Mjeti 10 ton* kryen shërbimin në *NJ.A. Rrethinat 2 herë/javë*,
  - ✓ *Mjeti 10 ton* kryen shërbimin në *NJ.A. Postribë 2 herë/ javë*
  - ✓ *Mjeti 5 ton* kryen shërbimin *1 herë në javë* në *NJ.A. Shalë*
- Numri i kontenierëve:150 copë të shpërndara në Rrethinat + 73 copë të shpërndara në Postribë + 21 copë të shpërndara në Theth, Shalë.

B. **ZONA FUNKSIONALE B, territori që mbulon Njësitë Administrative Ana Malit – Bërdicë – Guri i Zi**

Në 6-mujorin e parë të vitit shërbimi u mbulua me mjetet në dispozicion të Bashkisë Shkodër si dhe me burimet financiare për punonjës shërbimi, naftë, dhe transport e depozitim në landfill të mbetjeve.

Në 6 – mujorin e dytë ky shërbim është përmirësuar duke u bërë më I qëndrueshëm, sipas frekuencës së përcaktuar, me pika të grumbullimit të mbetjeve në secilën njësi dhe të shpërndara sipas nevojës dhe dakordësisë së vetë banorëve për shpërndarjen e kontenierëve të mbetjeve.

Shërbimi në këtë zonë funksionale përcaktohet si më poshtë:

- Mjetet që përdoren janë *2 mjete 10 ton;*
- Frekuenca e lëvizjes së mjeteve:
  - ✓ *Mjeti 10 ton* kryen shërbimin në *NJ.A. Ana Malit 2 herë/javë*,
  - ✓ *Mjeti 10 ton* kryen shërbimin në *NJ.A. Bërdicë 2 herë/ javë*,
  - ✓ *Mjeti 10 ton* kryen shërbimin *NJ.A .Guri i Zi 2 herë/javë*,
- Numri i kontenierëve:78 copë të shpërndara në Anë e Malit + 84 copë të shpërndara në Bërdicë + 96 të shpërndara në Gurin e Zi.

C. **ZONA FUNKSIONALE C, territori që mbulon Njësitë Administrative Velipojë – Dajç**

Gjatë vitit 2017 ky shërbim është dhënë në mënyrë të qëndrueshme, me frekuenca të përcaktuara, me pika grumbullimi dhe kontenierë të shtuar, të vendosur sipas kërkesës dhe dakortësisë së përfaqësuesve të komunitetit. Gjatë verës së vitit 2017, në Plazhin e Velipojës, ne mobilizuam më shumë burime financiare sesa në vitin 2016, pasi rritëm frekuencën nga dy në tre herë në ditë për periudhën 15 qershor-15 shtator për ngarkesat fundjavë gjatë sezonit, rritëm sipërfaqen e fshirë të rrugëve sidomos në qendër të plazhit, dhe ndërtuam dhe vumë në funksion sistemin e qëndrueshëm të monitorimit të shërbimit.

Shërbimi në këtë zonë funksionale përcaktohet si më poshtë:

- Mjetet që përdoren janë 2 mjete 10 ton. Për NJ.A. Velipojë pa zonën e Plazhit dhe Dajç; 2 mjete 5 ton për NJ.A. Velipojë zona e plazhit; 1 mjet 3 ton i hapur për NJA Velipojë për zonën e plazhit.
- Frekuenca e lëvizjes së mjeteve:
  - ✓ *Mjeti 10 ton* në *NJ.A. Velipojë (pa zonën e plazhit) 2 herë/javë*
  - ✓ *Mjeti 10 ton* në *NJ.A. Dajç 2 herë/ javë*
  - ✓ *Mjetet 5 ton NJ.A. Velipojë (zona e plazhit) 2 herë në ditë/7 ditëve të javës në stinën e verës*
- Numri i kontenierëve: 198 copë në Velipojë + 76 copë në Dajç

D. **ZONA FUNKSIONALE D:** Territori I qytetit Shkodër

Gjatë vitit 2017 kemi ngritur dhe bërë funksional sistemin e monitorimit përmes inspektorëve të lagjeve. Pavarësisht monitorimit që dhe raportimit dy herë në ditë, shpesh konstatojmë përsëri problematika momentale për pika të pa evaduara, për pika ku ka prurje të madhe momentale, për mungesë të zbatimit të rregullave të depozitimit të mbetjeve nga familjarë dhe biznese, për ndërhyrje në kontenierët nga persona të papërgjegjshëm, shpesh edhe të tregut informal, apo edhe djegie të kontenierëve.

Shërbimi në këtë zonë funksionale përcaktohet si më poshtë:

- Mjetet që përdorim janë: 5 mjete me kapacitet 10 ton.
- **Frekuenca e lëvizjes së mjeteve:**
  - ✓ 2 mjete 10 ton kryejnë shërbimin *2 herë në ditë/7 ditë* të javës në pjesën jugore të NJ.A.
  - ✓ 3 mjete nga 10 ton kryejnë shërbimin *2 herë në ditë/7 ditëve* të javës në pjesën jugore të NJ.A.
- Numri i kontenierëve:640

Gjatë vitit 2017 janë blerë 260 kazanë të cilët janë shpërndarë në njësi administrative dhe në qytetin e Shkodrës. Në bashkëpunim me dldp është realizuar marëveshja e bashkëpunimit përmes së cilës, Bashkia Shkodër ka përfituar një makinë për mbledhjen dhe transportin e mbetjeve dhe 140 kontenierë të cilët do të përdoren gjatë vitit 2018 për shtimin e tyre në pikat e grumbullimit sipas kërkesës së banorëve në çdo zonë.

**Gjatë vitit 2017 është realizuar kontrata me 673,200 lekë për ndërtimin e xhepave për vendosjen e kontenierëve duke krijuar kushte më të përshtatshme për depozitim dhe siguri publike.**

Me qëllim përmirësimin e shërbimit të pastrimit, gjatë muajve gusht dhe tetor, në çdo njësi administrative dhe lagje të qytetit kemi organizuar takime konsultative me qytetarët dhe bizneset.

Në këto takime janë diskutur problematikat dhe kërkesat për përmirësimin e shërbimit përkudnrejt përmirësimit të përformances, shtimit të kontrollit dhe monitorimit, ndërgjegjësimit dhe në disa raste është kërkuar shërbim shtesë për përiudha të caktuara, shtim pikash të grumbullimit, kërkesë për investime për kontenierë, shtim i sipërfaqes që do të fshihen mekanikisht dhe manulisht etj.

Në këto takime qytetarët kanë diskutuar hapur dhe kanë dhënë mendimet e tyre. Në shumicën e njësive ata kanë marrë vendimin lidhur me shtimin e shërbimit shërbimin, standartin e përmirësuar shtesë që ata kërkojnë përkundrejt angazhimit për pagesën e shtesës së diferencës.

**Më saktësisht kërkesat e banorëve për çdo njësi paraqiten:**

| Përbërja | Infrastruktura | | Të dhënat teknike | | Distancat | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Mjetet | Kontenierë | Norma e gjenerimit | Frekuenca | Distanca nga landfilli (1 kah)* | Distanca për grumbullimin për kamion** |
| **Njësitë e Zonës Lindore** | | | | | | |
| Rrethinat, Postribë, Shalë, Pult, Shosh, Guri i Zi | 3 mjet 10 ton/ 1 turne (mjeti i trete mund të merret 5ton për rrugët e ngushta) | Shtohen 232 - (Total 497) | 0.3 kg/banorë/ditë | 2.5 herë/javë | 56 | 400 |
| **Njësitë e Zonës Perëndimore** | | | | | | |
| Ana Malit, Bërdicë, Velipojë, Dajç | 3 mjet 10 ton/ 1 turne (mjeti i trete mund të merret 5ton për rrugët e ngushta) | Shtohen 100 (Total 243) | 0.3 kg/banorë/ditë | 2.5 herë/javë | 18 | 229 |
| Veipojë Plazh | 2 mjete 5ton/2 turne | Shtohen 63 (Total 223) | 0.75 kg/banorë/ditë | 7ditë/javë/2 herë/ ditë | 35 | 60 |
| **Njësitë e zonës së qendrës** | | | | | | |
| Shkodër | 4 +1 mjete 10ton (mjeti reserve mund të jetë 5 ton për turnin e dytë në disa rrugë) | Shtohen 150 (Total 759) | 0.9 kg/banorë/ditë | 7ditë/javë | 16 | 25 |
| Fshirja manuale | | | | | | 157,465 |
| Fshirja mekanike | 1 mjet fshirje mekanike | | | 2 herë/javë | | 343,077 |
| Mjeti 5 ton për rrugicat e ngushta (Shkodër) | 1 mjet 5 ton | Shtohen 10 (Total 24) | | 7ditë/ditë | 16 | 3 |

Duke marrë në konsideratë kërkesat për përmirësim të shërbimit të grumbullimit, transportimit dhe depozitimit të mbetjeve në landfill, janë berë llogaritjet për nxjerrjen e kostove optimale që marrin në konsideratë:

- Zgjerim i shërbimit në territor;
- Uljen e kostos së transportit;
- Përdorimin me efiçiencë të mjeteve;
- Llogaritje më e mirë e normës së prodhimit të mbetjeve për cdo njësi, për familje dhe biznese, referuar historikut të të dhënave dhe përllogaritjeve që marrin në konsideratë vendosjen e popullsisë, dhe të bizneseve.;
- Shtim i pikave të grumbullimit;
- Shtim i kontenierëve;
- Përmirësimin e sigurisë në rrugë përmes krijimit të hapësirës së përshtatshme për vendosjen e pikave të grumbullimit;
- Zbatim i sistemit të monitorimit të shërbimit në mënyrë më të automatizuar në të gjithë territorin;
- Sensibilizim i popullatës për shërbimin, ruajtjen e mjedisit, bashkëpunimin për një qytet të pastër;
- Përmirësimin e sigurisë në rrugë përmes krijimit të hapësirës së përshtatshme për vendosjen e pikave të grumbullimit;

Për realizimin e shërbimit të grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane janë llogaritur kostot e shërbimit si më poshtë për numrin e pikave të grumbullimit, numër kontenierësh, numër dhe lloji i mjeteve dhe transporti në landfill, sipas normës së gjenerimit të mbetjeve dhe frekuencës së shërbimit.

| **Zona Lindore** | **Kosto e shërbimit** |
|---|---|
| | 12 mujore (LEK/vit) |
| **Njësitë e Zonës Lindore (Rrethinat, Postribë, Shalë, Pult, Shosh, Guri i Zi)** | |
| Nën kosto e mirëmbajtjes së mjeteve (Sigurimi kamionit, Vaj+filtra, Goma, Mirëmbajtje mekanike, Parkim) | 241,811 |

| | |
|---|---|
| Nën kosto për grumbullim dhe transport | 5,342,427 |
| Nën kosto e personelit (3 shofera+ 6 punonjës) | 2,242,297 |
| **Nën Kosto Totale (Grumbullim, Transport, Personel, Mirëmbajtje)** | **7,826,535** |
| **Nën kosto e depozitimit në landfill** | **3,895,646** |
| Nën kosto e amortizimit të kontenierëve | 2,607,649 |
| Nën kosto e amortizimit të mjeteve | 333,532 |
| **Nën kosto totale e amortizimit** | **2,941,181** |
| **Nën kosto administrative/ për grumbullimin e taksave/ fushatë ndërgjegjësimi)** | **2,786,039** |
| **Fitimi nga të ardhurat neto (4%)** | **586,534** |
| **KOSTO TOTALE OPERACIONALE (Mirëmbajtje, grumbullim, transport, personel, depozitim, amortizim + kostot administrative dhe fitim neto)** | **18,035,935** |

| **Zona Perëndimore** | **Kostot e shërbimit** | | **Totali kosto** |
|---|---|---|---|
| | 12 mujore (LEK/vit) | 12 mujore (LEK/vit) | 12 mujore (LEK/vit) |
| **Njësitë e Zonës Perëndimore (Ana Malit, Bërdicë, Dajç, Velipojë)** | | **Velipoja Plazh** | **Zona P** |
| Nën kosto e mirëmbajtjes së mjeteve (Sigurimi kamionit, Vaj+filtra, Goma, Mirëmbajtje mekanike, Parkim) | 152,929 | 963,318 | 1,116,247 |
| Nën kosto për grumbullim dhe transport | 2,429,727 | 2,628,365 | 5,058,092 |
| Nën kosto e personelit (3 shofera+ 6 punonjës) (2 shofera+4 punonjës plazhi) | 3,784,110 | 2,609,356 | 6,393,466 |
| **Nën Kosto Totale (Grumbullim, Transport, Personel, Mirëmbajtje)** | **6,366,766** | **6,201,039** | **12,567,805** |
| **Nën kosto e depozitimit në landfill** | **2,099,190** | **1,770,820** | **3,870,010** |
| Nën kosto e amortizimit të kontenierëve | 1,273,820 | 1,172,996 | 2,446,816 |
| Nën kosto e amortizimit të mjeteve | 210,936 | 886,253 | 1,097,189 |
| **Nën kosto totale e amortizimit** | **1,484,756** | **2,059,249** | **3,544,005** |
| **Nën kosto administrative/ për grumbullimin e taksave/ fushatë ndërgjegjësimi)** | **1,890,635** | **1,905,911** | **3,796,546** |
| **Fitimi nga të radhurat neto (4%)** | **398,028** | **401,244** | **799,273** |
| **KOSTO TOTALE OPERACIONALE (Mirëmbajtje, grumbullim, transport, personel, depozitim, amortizim + kostot administrative dhe fitim neto)** | **12,239,376** | **12,338,263** | **24,577,639** |

| **Zona Qendrore** | **Kostot shërbimit** | | **Totali kosto** |
|---|---|---|---|
| | 12 mujore (LEK/vit) | 12 mujore (LEK/vit) | 12 mujore (LEK/vit) |
| **Njësitë e Zonës Qendrore (Shkodër)** | | **Zonat me rrugica të ngushta** | **Zona Qendrore** |
| Nën kosto e mirëmbajtjes së mjeteve (Sigurimi kamionit, Vaj+filtra, Goma, Mirëmbajtje mekanike, Parkim) | 2,031,996 | 585,000 | 2,616,996 |
| Nën kosto për grumbullim dhe transport | 19,917,320 | 1,574,245 | 21,491,565 |
| Nën kosto e personelit (5 shofera+ 15 punonjës) | 43,502,611 | 845,439 | 44,348,050 |
| **Nën Kosto Totale (Grumbullim, Transport, Personel, Mirëmbajtje)** | **65,451,926** | **3,004,684** | **68,456,611** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Nën kosto e depozitimit në landfill** | **26,882,820** | **597,376** | **27,480,196** |
| Nën kosto e amortizimit të kontenierëve | 3,984,034 | 123,532 | 4,107,565 |
| Nën kosto e amortizimit të mjeteve | 4,149,739 | 538,200 | 4,687,939 |
| **Nën kosto totale e amortizimit** | **8,133,773** | **661,732** | **8,795,504** |
| **Nën kosto administrative/ për grumbullimin e taksave/ fushatë ndërgjegjësimi)** | **19,089,019** | **810,120** | **19,899,139** |
| **Fitimi nga të radhurat neto (4%)** | **4,018,741** | **170,552** | **4,189,292** |
| Nën kosto fshirje manual | 13,149,997 | **-** | 13,149,997 |
| Nën kosto fshirje dhe larje mekanike | 8,756,856 | **-** | 8,756,856 |
| Nën kosto fikse (amortizim/ administrative) | 2,502,400 | **-** | 2,502,400 |
| **Nën Kosto e plotë për fshirje larjen** | **24,409,253** | **-** | **24,409,253** |
| **KOSTO TOTALE OPERACIONALE (Mirëmbajtje, grumbullim, transport, personel, depozitim, amortizim + kostot administrative dhe fitim neto)** | **147,985,532** | **5,244,464** | **153,229,996** |

**Përmbledhja e kostove**

| **Nën zërat e kostos** | **KOSTO (LEK/vit)** | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Zona Lindore** | **Zona Perëndimore** | **Zona e Qendrës** | **BASHKIA TOTAL** |
| **Nën Kosto Totale (Grumbullim, Transport, Personel, Mirëmbajtje)** | 7,826,535 | 12,567,805 | 68,456,611 | 88,850,950 |
| **Nën kosto e depozitimit në landfill** | 3,895,646 | 3,870,010 | 27,480,196 | 35,245,852 |
| **Nën kosto totale e amortizimit** | 2,941,181 | 3,544,005 | 8,795,504 | 15,280,691 |
| **Nën kosto administrative/ për grumbullimin e taksave/ fushatë ndërgjegjësimi)** | 2,786,039 | 3,796,546 | 19,899,139 | 26,481,724 |
| **Fitimi nga të radhurat neto (4%)** | 586,534 | 799,273 | 4,189,292 | 5,575,100 |
| **Nën Kosto e plotë për fshirje larjen** | 0 | 0 | 24,409,253 | 24,409,253 |
| **KOSTO TOTALE OPERACIONALE (Mirëmbajtje, grumbullim, transport, personel, depozitim, amortizim + kostot administrative dhe fitim neto)** | **18,035,935** | **24,577,639** | **153,229,996** | **195,843,570** |

**Kjo kosto mbulohet nga të ardhurat nga tarifa si më poshtë:**

**Të ardhurat e planifikuara nga familjet:**

| **Nr. Familjeve** | **Tarifa e pastrimit** | **Te ardhurat sipas kapacitetit të plotë të familjeve** | Përqindje e kostot totale sipas kapacitetit të plotë | Përqindje e kostot totale e mbuluar nga të ardhurat e mbledhuara nga të gjitha familjet duke hequr familjet me lehtësi fiskale | Mbulimi I kostos nëse mblidhen të gjitha tarifat nga të gjitha familjet duke hequr familjet me lehtësi fiskale |
|---|---|---|---|---|---|
| 4,901 | 1,950 | 9,556,950 | | | |
| 1,609 | 1,950 | 3,137,550 | | | |
| 477 | 1,450 | 691,650 | | | |
| 334 | 1,450 | 484,300 | | | |
| 80 | 1,450 | 116,000 | | | |
| 1,907 | 1,950 | 3,718,650 | | | |
| 1,017 | 1,950 | 1,983,150 | | | |
| 1,425 | 1,950 | 2,778,750 | | | |
| 1,152 | 1,950 | 2,246,400 | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1,270 | 1,950 | 2,476,500 | | | |
| 21,253 | 3,450 | 73,322,850 | | | |
| **35,425** | | **100,512,750** | **51%** | **37%** | **73,301,000** |

**Të ardhura të planifikuara nga Biznesi i Madh dhe Institucionet:**

| | Nr. BM | Tarifa (lek/vit) | Të ardhurat e mundshme nga tarifa | |
|---|---|---|---|---|
| Njesia Administrative Shkodër, Plazh Velipoje | 781 | 33,000 | 25,773,000 | Mbulimi I kostos nëse mblidhen të gjitha tarifat |
| Njësi tregtare dhe shërbimi në Njësitë e tjera Administrative | 266 | 33,000 | 8,778,000 | |
| Njësi tregtare për tregtim karburanti | 43 | 48,000 | 2,064,000 | |
| Njësi prodhimi në Njësinë Administrative Shkodër | 80 | 63,000 | 5,040,000 | |
| Njësi prodhimi në Njësitë e tjera Administrative | 9 | 33,000 | 297,000 | |
| Subjekte ndërtuese për selinë administrative | 39 | 73,000 | 2,847,000 | |
| Subjektet e ndërtimit sipas investimit, dhe kohëzgjatjes së kantierit të ndërtimit | 10 | 20,000 -200,000 | 640,000 | |
| Shoqata, fondacione, ente të ndryshme shtetërore, organizata joqeveritar, | 48 | 6,000 | 288,000 | |
| Institucione | 50 | 8,000 | 400,000 | |
| | **1,326** | | **46,127,000** | **24%** |

**Të ardhura të planifikuara nga Biznesi i vogël:**

| BV | Nr. BV | Tarifa (lek/vit) | Të ardhurat e mundshme nga tarifa | |
|---|---|---|---|---|
| Njësi tregtare dhe Shërbimi në NJA Shkodër | 2,845 | 13,000 | 36,985,000 | Mbulimi I kostos nëse mblidhen të gjitha tarifat |
| Njësi tregtare dhe Shërbimi në NJA të tjera | 1,191 | 8,000 | 6,804,000 * | |
| Njësi prodhimi në NJA Shkodër | 196 | 13,000 | 2,548,000 | |
| Njësi prodhimi në NJA e tjera | 56 | 8,000 | 448,000 | |
| Ambulant | 121 | 5,500 | 665,500 | |
| **Total** | **4,409** | | **47,450,500** | **25%** |

* Zona Plazh Velipoje dhe Baks/Rrjoll vetëm sezoni turistik

**Kostoja e plotë e shërbimit mbulohet nga 166,879,000 lekë nga të ardhurat nga tarifa, ose 85% e totalit të kostos. Bashkia planifikon të subvencionojë28,964,570 lekë, osë15% nga transferta e pakushtëzuar.**

| | | |
|---|---|---|
| **Totali i mbulimit të kostos nga tarifat (LEK/vit)** | 166,879,000 | **85%** |
| **Subvencionim nga Bashkia (LEK/vit)** | 28,964,570 | **15%** |




**ii. Synimi i projektit të vitit 2018-2020**

- Zgjerim i shërbimit në territor nga 75 % në 95%
- Rritje e frekuencës sështhërbimit të të mbledhjes, transportimit dhe depozitimit të mbetjeve në landfill;
- Optimizimin e kostove të transpostit;
- Përdorimin me efiçiencë të mjeteve të punës;
- Llogaritje më e mirë e normës së prodhimit të mbetjeve për cdo njësi, për familje dhe biznese, referuar historikut të të dhënave dhe përllogaritjeve që marrin në konsideratë vendosjen e popullsisë, dhe të bizneseve.;
- Shtim i pikave të grumbullimit;
- Shtim i kontenierëve nga 1,580 në 2,100
- Përmirësimin e sigurisë në rrugë përmes krijimit të hapësirës së përshtatshme për vendosjen e pikave të grumbullimit;
- Zbatim i sistemit të monitorimit të shërbimit në mënyrë më të automatizuar në të gjithë terrtiorin;
- Sensibilizim i popullatës për shërbimin, ruajtjen e mjedisit, bashkëpunimin për një qytet të pastër;

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

-Vazhdimi i kryerjes se sherbimit te Pastrimit me sipermarrje private deri ne perfundim te kontrates ekzistuese, 30.09.2018.
-Përgatitja e dokumentacionit për proceduren e prokurimit për tenderin shumëvjecar të shërbimit të pastrimit , për të gjithë qytetin .
-Bashkëpunimi me Drejtorinë Juridike për strukturen e kontratës së re të shërbimit të pastrimit për kërkesat teknike dhe kapitullin e penaliteteve.
-Riorganizimi i PGM dhe rritja e numrit të tyre duke shtuar dhe numrin e kazanëve, si dhe ndërtimi i xhepave tëe kazaneve në trotuare.
-Vendosja e kazanëve të diferencuar në ngjyra për ndarje të mbetjeve ne: të thata dhe të njoma, në tre zona pilot të qytetit..
Bashkëpunimi i vazhdushëm me komunitetin dhe ndërgjegjesimi i tyre për diferencimin e mbetjeve që në burim.
Bashkëpunimi me shkollat, institucionet dhe biznesin për rritjen e interesit për ndarjen e mbetjeve të riciklueshme duke vazhduar eksperiencen e krijuar në mardhënie me to.
-Vazhdimi i depozitimit te të gjitha MU në Landfillin Bushat.
-Sistem monitorimi me gjithpërfshirës, duke bërë pjese dhe komunitetin.
-Investime.
**Për shërbimin e pastrimit të Njesive Administrative.**
-Vazhdimi i kryerjes se sherbimit te Pastrimit me sipermarrje private deri ne perfundim te kontrates ekzistuese, 30.09.2018
-Pregaditja e dokumentacionit per proceduren e prokurimit per tenderin shumevjecar te sherbimit te pastrimit , per zonen lindore ( Rrethina, Postribe, Shale dhe Guri Zi ) dhe zones perendimore( Velipoje, Dajc, Berdice dhe Ana Malit )
-Bashkepunimi me Drejtorine Juridike per strukturen e kontratave te reja te sherbimit te pastrimit per kerkesat teknike dhe kapitullin e penaliteteve.
-Riorganizimi i PGM dhe rritja e numrit te tyre duke shtuar dhe numrin e kazaneve.
- Bashkëpunimi i vazhdushëm me komunitetin dhe ndergjegjesim per marredhenien me mbetjet urbane.
-Vazhdimi i depozitimit te te gjitha MU ne Landfillin Bushat.
-Organizimi i sistemit te monitorimit per cdo fshat, duke perfshire dhe kryepleqt.
- Eliminimi I mbeturinave urbane nga vendepozitimet e palejueshme me mjetet e bashkisë si dhe kryerjen e shërbimit në ato zona të pa parashikuara në sipërmarrjet private.
-Investime.
**Viti 2019**

- -Vazhdimim i sherbimit te Pastrimit me sipermarrjen e re private te dale nga tenderi i tetorit 2018.
- Eliminimi I mbeturinave urbane nga vendepozitimet e palejueshme me mjetet e bashkisë si dhe kryerjen e shërbimit në ato zona të pa parashikuara në sipërmarrjet private.
- -Vazhdimi depozitimit te mbetjeve urbane ne landfillin Bushat.
- -Ne kuader te permisimit te performances se sherbimit te kemi sistem monitori variabel duke u perqendruar ne pikat problematike.

- Investime.

**Viti 2020**

-Vazhdimi I aktivitetit të shërbimit të pastrimit me sipermarrjen private sipas tre kontratave.
- Eliminimi I mbeturinave urbane nga vendepozitimet e palejueshme me mjetet e bashkisë si dhe kryerjen e shërbimit në ato zona të pa parashikuara në sipërmarrjet private.
-Vazhdimi depozitimit te mbetjeve urbane ne landfillin Bushat.
-Investime.

**b) Rezultatet që prisni**

**Viti 2018**
**Për shërbimin e pastrimit të qytetit** .

- Shërbim me parametra të përmiresuar për të gjithë territorin.
- Shtimi i pikave të vendeve të grumbullimit të mbeturinave dhe numrit të kazaneve për ti shërbyer më mire familjareve dhe bizneseve.
- Depozitimi mbetjeve ndërtimore në vend depozitime të miratuara.
- Fillimi i diferencimit te mbetjeve urbane qe ne burim dhe grumbullimi tyre ne orare te percaktuar sipas nje grafiku paraprak.
- Interesimi i biznesit per fillimin e procesit te riciklimit.
- Monitorim i sakte dhe raportim on-line nga supervizoret dhe inspektoret e lagjeve.
- Realizimi i xhepave te kazaneve , element te sigurise rrugore.
- Realizimi i tenderit te ri ne tetor dhe fillimi i ketij sherbimi me sipermarrjet e reja private qen nga tetori

**Për shërbimin e Pastrimit në Njesitë Administrative.**

-Realizimi i shërbimit të grumbullim transportit të mbeturinave në të njejtat standarte si në qytet.
-Kazanë metalike në pikat e grumbullimit të mbeturinave duke rritur rendimentin e punes, duke eleminuar problemet mjedisore si dhe ofrimin e shërbimit me përmirësim standartesh.
Rritja e numrit të përfituesve të shërbimit në pjesën më të madhe të njesive administrative.
Depozitimi i të gjitha mbetjeve urbane në landfillin Bushat dhe eleminimi i vend depozitimeve të pamiratuara.

**Viti 2019**

Shërbim pastimi me sipermarrje private në të gjithë Bashkinë.
Fillimin e një shërbimi pas lidhjes së kontratës së re me standart shumë të larta, në përputhje me kuadrin ligjor dhe kerkesat ekomunitetit
Reduktim i sasise së mbetjeve që depozitohen në landfill, nëpërmjet rritjes së sasisë së mbetjeve të riciklueshme .

**Viti 2020**

Vazhdimi i shërbimit me standarte të larta në të gjithë Bashkinë.
Rritje të ndërgjegjësimit dhe edukimit mjedisor për menaxhimin e mbetjeve urbane, nga ana e banorve dhe bizneseve.
Ritja e numrit te perfituesve të shërbimit të pastrimit duke shtrire gjeografikisht këtë e aktivitet.
Pika te vendgrumbullimit të mbetjeve të sistemuara dhe definitive, nga realizimi i xhepave.
Rritje të numrit të pikave të grumbullimit, duke realizuar blerjen e kazaneve për mbetjet urbane.
Rritje të numrit të kazaneve që përdoren për materiale të riciklueshme.
Reduktim i sasisë së mbetjeve që depozitohen në landfill, nëpërmjet rritjes së sasisë së mbetjeve të riciklueshme në masën 10 %.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuoje për këtë projekt, financiarisht etj.)** |
|---|---|
| Operatori që kryen këtë shërbim për qytetin.<br>Sipermarresi e kontraktuar për ndërtimin e xhepave dhe furnizimin me kazana.<br>Monitoruesit , rajonet dhe komuniteti.<br>Bizneset<br>Banorët e qytetit të Shkodrës | Buxheti i Bashkise |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali ( mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operativ | Transferi | Kapitale |
| A.1 | Shërbimi i pastrimit qytet deri 1.10.2018 (kontratë vazhdim) | **74,434** | | | 74,434 | | |
| A.2 | Shërbimi I pastrimit Nj. Ad. Velipoje – Dajçderi 1.10.2018 (kontratë vazhdim) | **11,150** | | | 11,150 | | |
| A.3 | Shërbimi I pastrimit Nj. Ad. Rrethina, Postribe Shale deri 1.10.2018 (kontratë vazhdim) | **10,106** | | | 10,106 | | |
| A.4 | Shërbimi I pastrimit Nj. Ad. Guri Zi, Berdice, Ana Malit deri 1.10.2018 (kontratë vazhdim) | **5,284** | | | 5,284 | | |
| A.5 | Depozitim i mbetjeve në landfill gjithë Bashkia, deri 1.10.2018 | **31,697** | | | 31,697 | | |
| A.6 | Shërbimi i pastrimit për gjithë Bashkinë nga 1.10.2018 (5-vjeçare me vlerë limit | | | | | | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 979,218 mije/leke) | | 48,961 | | | 48,961 | | |
| A.7 | Investime | | | | | | | |
| | A7.1 | Ndertim xhepa kazanesh për mbeturina. | **1,200** | | | | | 1,200 |
| | A7.2 | Blerje kazanësh | | | | | | |
| | A.7.3 | Pajisje Elektronike monitorimi | **450** | | | | | 450 |
| A.8 | Shpenzime për 2 mjete transporti | | | | | | | |
| | A8/1 | Karburant | 560 | | | 560 | | |
| | A8/2 | Furnizim vendosje pjesë këmbimi dhe mirëmbajtje e makinerive | 520 | | | 520 | | |
| | A8/3 | Siguracion | 60 | | | 60 | | |
| | A8/4 | Takse e kolaudim | 140 | | | 140 | | |
| | **TOTALI** | | **184,562** | | | **182,912** | | **1 650** |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2019** | | | | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Paga | Sigurime | Operativ | Transfer | Kapitale |
| A.1 | Shërbimi i pastrimit për gjithë Bashkinë | | 195,000 | | | 195,000 | | |
| A.2 | Investime | | 5,000 | | | | | |
| | A8/2 | Blerje kazanësh | | | | | | 5,000 |
| | **TOTALI** | | **200,000** | | | **195,000** | | **5,000** |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2020** | | | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operativ | Transfer | Kapitale |
| A.1 | Shërbimi i pastrimit për gjithë Bashkinë | 195,000 | | | 195,000 | | |
| A.2 | Investime | 12,000 | | | | | 12,000 |
| | **TOTALI** | **207,000** | | | **195,000** | | **12,000** |

| **f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)**<br><br>**Janar 2018 deri me 31 Dhjetor 2020** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>**Drejtoria Shërbimeve Publike dhe ndjekjes së investimeve.**<br>**Drejtoria Buxhetit**<br>**Njesia Prokurimit**<br>**Drejtoria Juridike**<br>**Drejtoria Finances** |
|---|---|

| Nr.2 | **Projekti: P4.F2.O1.A0-A3**<br>Shërbimi i Mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra. | **Llojet e programit: P4.**ShërbimetPublike<br>**Funksioni: F2.**Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike; |
|---|---|---|
| **a) Përshkrimi i shkurtër i projektit** | | |
| **I. Situata** | | |
| **A. Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta në qytet.**<br>Gjatë vitit 2017 kemi realizuar mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta dhe të gjelbërimit rrugor.<br>Shërbimi realizohet për mirëmbajtjen e 72 600 $m^2$ sipërfaqe të gjelbër ,ku përfshihen 54 lulishte.Shërbimet për mirëmbajtjen e siperfaqes së barit, drurëve dekorativë, shkurreve, sipërfaqeve ujore, stolave, pastrim i rrugëve të brendshme etj., janë pjesë të preventivit të punimeve që realizohen sipas kontratës 5-vjeçare, e cila përfundon me datë 20 Janar 2018. Elementet atraktiv të këtyre sipërfaqeve, krijojnë kushte më të favorshme për frekuentim nga meshkujt se sa nga femrat ,kështu që raporti duhet përmirësuar duke riorganizuar këto sipërfaqe për t'i shërbyer më | | |

shumë familjeve dhe banorëve të qytetit.

Situata e vlerësuar:

- Dëmtimi i sipërfaqeve të lulishteve:
  Dëmtimi i stolave nga amortizimi, por edhe nga veprimet e qëllimshme nga persona të papërgjegjshem.
  Mungesa e infrastrukturës në lulishte për vendosjen e biçikletave.
  Mungesa e çesmave publike në lulishtet më të frekuentuara nga banorët.
  Pengesat nga parkingjet për realizimin e shërbimeve të pemëve në gjelbërimin rrugor.

- Ndotja e shatërvaneve, shpesh nga papërgjegjëshmeria e qytetarëve që hedhin mbeturina në to.
  Planifikimi i ndërhyrjes për riorganizimin e hapësirave të gjelbërta, duke u mbeshtetur ne kulturen dhe traditen e qytetit ne kultivimin e bimëve tradicionale.

**B.Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta Nj.Administrative.**

Në **Nj.Ad Velipojë** ka sipërfaqe të gjelbër (lulishte) për të cilën është realizuar shërbim mirëmbajtje sezonale.Shërbimi është realizuar në një sipërfaqe prej 17 000 $m^2$ lulishte dhe 491 $m^2$sipërfaqe ujore (shatërvanet). Brenda kësaj sipërfaqeje ka dhe elementë të tjerë si, stola dekorativ 100 copë dhe drurë dekorativ 120 copë, gjelbërim rrugor 78 rrënjë. Ky shërbim është realizuar me kontratë sipërmarrje.
Në njesitë administrative Rrethina-Postribë (mbikalim tek Ura e Bardhajve) në vitin 2016 është realizuar gjelbërimi rrugor me 1200 pemë. Ky investim e ka përfunduar periudhën e garancisë dhe domosdoshmerisht do të mirëmbahet nga Bashkia Shkodër në vazhdim.
Në Nj.Ad. Ana e Malit nga buxheti i Bashkisë Shkodër të vitit 2017 është realizuar investimi për ndërtimin e lulishtes në qendren Oblikë, me 200 $m^2$ dhe gjelbrimi rrugor pranë doganës Muriqan me 143 rrënjë

Situata e vlerësuar:

- Gjendja aktuale e hapësirave publike të gjelbërta në Njësi adminsitrative është e degraduar, pasi shërbimi i mirëmbajtjes së tyre nuk është kryer sipas sezonit dhe cikleve të nevojshmë për bimësinë.
- Në shumë njësi administrative gjelbërimi rrugor është i mangët. Në veçanti, zonat më të frekuentuara nga qytetarët dhe vizitorët vendas dhe të huaj.
- Vështirësia në qarkullim në rrugët rurale nga prezenca e shkurreve dhe barërave në bankina

**II. Synimi iprojektit** 2018-2019-2020

**-**Fillimi i realizimit të shërbimit të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra , për të gjithë Bashkinë me sipërmarrje private, duke rritur sipërfaqet e gjelbërta për shërbim me 17 810 $m^2$apo ndryshe, me 7 lulishte të reja , si dhe drurëve të gjelbërimit rrugor me 1200 copë.
Kryerje e një shërbimi në lulishte sipas tipologjive (A, B, C)të sipërfaqeve të gjelbra.
E njëjta gjë dhe për gjelbërimin rrugor, shërbim I vecantë për ato, sipas lartësive, por edhe sipas rëndësisë, duke e ndarë në: gjelbërim rrugor standart dhe gjelbërim rrugor në rrugë historike.

1- Riorganizimi i sipërfaqeve të gjelbra në kuadër të përmisimit të peisazhit urban dhe historik , si dhe për të qënë funksional për të gjithe komunitetin si dhe duke prezantuar me bimesi sipas traditës dhe kulturës së qytetit , trëndafila, lule vjolë, kadife,etj.
2- Ofrim i shërbimit te mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta për të gjitha lulishtet e qytetit.
3- Krijimi i sipërfaqeve të reja të gjelbra, me investime.
4 - Zgjerim i gjelbrimit rrugor në Nj.A, sipas prioriteteve.
5- Shërbim periodik i mirëmbajtjes edhe për pika të rëndësishme turistike të qytetit, si rruga e KalasëRozafat,Bregu i liqenit dhe tek Ura e Mesit, sipas eventeve të ndyshme në këto dy zona.
6 - Mirëmbajtje e infrastruktures rrugore ne Nj.A , duke i pastruar nga bimësia e gjelbër.(shkurre, ferra, barërat e lartë.)
7 - Mirëmbajtje e bankinave të rrugëve dhe trotuareve duke i pastruar nga bimësia e gjelbërt (bari).

Planifikimi për shërbimin në vitin 2018:

| | |
|---|---|
| Mirëmbajtje Sipërfaqe e Gjelbërt gjithë Bashkia | **36,530,000** |
| **Investime** | **1,749,000** |
| **TOTAL** | **38,279,000** |

**Mbulimi i kostove të shërbimit të gjelbërimit për vitin 2018 përllogaritet si më poshtë:**

| Familjet | Nr. i familjeve përfituese të shërbimit | Nr. i mesatarizuar i familjeve që paguajnë (jane hequr familjet me lehtësi fiskale) | Tarifa e gjelbrimit | Të ardhurat nga tarifat e gjelbrimit |
|---|---|---|---|---|
| Shkodër | 21,253 | 15,781 | 600 | 9,469,000 |
| TOTAL | | | | **9,469,000** |

| | |
|---|---|
| Të ardhura nga biznesi | **11,915,000** |
| Të ardhurat nga institucionet | **125,000** |

**TOTALI I TË ARDHURAVE TË PLANIFIKUARA** **21,509,000**




**III. Aktivitetetkryesoretëprojektit**

**Viti 2018**
Hartimi i Planit të veprimit për ofrimin e shërbimit të gjelbërimit.
Realizimi i proçedurave për realizimin e shërbimit.
Realizimi i investimive për krijimin e sipërfaqeve të reja të gjelbërta.
Realizimi i investimit për zgjerim tëgjelbërim rrugor
Hartim dhe vënie në zbatim e sistemit të monitorimi ti standartizuar ne kuadër të plotësimit të detyrimeve kontraktuale, apo detyrave të përcaktuara për strukturat publike të shërbimit.

**Viti 2019 – 2020**
Sipas përcaktimeve afatmesme të Planit të veprimit për shërbimin e gjelbërimit:
Përmirësim i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra për të gjithë Bashkinë.
Rritje e i investimeve për gjelbërim rrugor në Nj.A.
Përmirësim i përformancës së ofrimit të shërbimit të gjelbërimit përmes zbatimit dhe funksionimit të sistemit të monitorimit.

**b) Rezultatetqëprisni**

**Viti 2018- 2019 - 2020**
Do të hartohet një plan i saktë veprimi për një periudhë afatmesme, I cili do të analizojë nevojat, kostot, dhe do të përcaktojë në kohë afatmesme synimet dhe indikatorët e matshëm për përfomancën e ofrimit të shërbimit.
Ofrim i shërbimit të standartizuar për hapësirat e gjelbërta ekzistuese.
Rritje në përqindje dhe dendësi e sipërfaqeve të gjelbërta, funsionale në shërbim të qytetarëve të Shkodrës.
Rritje e performancës së ofrimit tëshërbimit nëpermjët një sistemi më efikas të matjes dhe monitorimit.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Operatori që kryen këtë shërbim për qytetin.<br>Sipërmarrësit e kontraktuar për sipërfaqet e reja .<br>Monitoruesit, rajonet, Nj.Ad. dhe komuniteti. | Buxheti i Bashkisë. Grante. |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A. 0 | Hartimi i Planit të veprimit për ofrimin e shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë Shkodër. | | | | | | |
| A.1 | Ofrim i shërbimit të gjelbërimit në qytetin e Shkodrës (deri me 24 Janar 2018) | 1686 | | | 1686 | | |
| A.2 | Ofrim i shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë e Shkodrës | 34844 | | | 34844 | | |
| A.3 | Investime | 1749 | | | | | 1 749 |
| | **Shuma** | **38279** | | | 36530 | | 1 749 |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2019** | | Totali (mije | Nga kjo: | | | | |

| | | lekë) | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Ofrim i shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë e Shkodrës | 37330 | | | 36530 | | 800 |
| | **Shuma** | **37330** | | | 36530 | | **800** |
| | | | | | | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2020** | | Totali<br><br>(mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Ofrim i shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë e Shkodrës | 38060 | | | 37260 | | 800 |
| | **Shuma** | 38060 | | | 37260 | | **800** |
| **f) Periudha e zbatimit**<br><br>**Janar 2018 deri 31 Dhjetor 2020.** | | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br><br>Drejtoria e Shërbimeve Publike;<br>Drejtoria e Buxhetit;<br>Drejtoria e financës;<br>Drejtoria Juridike,<br>Konsulentë mbështetës; | | | | | |

| Nr.3 | **Projekti P4.F3.O1:A1**<br><br>Furnizimi me ujë i qytetit dhe njësive administrative | **Llojet e programit P4.:** Shërbimet Publike<br>**Funksioni P4.F3 :** Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm |
|---|---|---|
| **a) Përshkrimi i shkurtër i projektit** | | |
| i. Situata | | |

Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Shkodër, në zbatim të VKM Nr. 63 datë 27.01.2016 ''Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura'', ka vazhduar punën e marrjes në dorëzim gradualisht të sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm, duke marre ne dorezim ne Prill te 2017 edhe Stacionin e pompimit Trush dhe Depot perkatese qe furnizojne me uje Njesine Administrative Velipoje. Me poshte paraqitet nje tabele permbledhese e sistemeve te marra ne dorezim dhe qe operohen nga UK Shkoder.

| **Vendodhja** | **Nr. Stacioneve të pompimit** | **Nr. Rezervuareve** | **Gjendja e rrjetit shpërndarës** |
|---|---|---|---|
| Nj.A Bërdicë | 3 | 3 | Shumë i amortizuar |
| Zues | 1 | 1 | Shumë i amortizuar |
| Obot | 1 | 1 | Shumë i amortizuar |
| Zogaj | 1 | 1 | |
| Dajc | 4 | 4 | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Gur i zi | 1 | 1 | Shumë i amortizuar |
| Juban | 1 | 1 | Jashtë funksioni |
| Nj.A shalë | Vetrrjedhje | 4 | Investim i ri |
| Dragoç i ri | Vetrrjedhje | | Investim i ri |
| Mes-Meselin | 1 | 1 | Shumë i amortizuar |
| Drisht | 1 | 1 | Shumë i amortizuar |
| Oblikë | 1 | 2 | Shumë i amortizuar |
| Hot i ri | 1 | 1 | |
| Trush | 1 | 1 | |

Gjithsesi edhe për sistemet e furnizimit me ujë të Njësive Administrative të marra në administrim nga UK Shkodër deri tani, rezulton se:

- Të gjithë janë ujësjellësa shumë të amortizuar (përjashto Dragoçin e ri dhe Thethin)
- Disa sisteme janë totalisht jashtë funksionit.
- Janë sisteme ujësjellësi me ngritje mekanike, me kosto të lartë konsumi të energjisë elektrike dhe debi të trashëguara.
- Me kosto të lartë operim-mirëmbajtje dhe që nuk plotësojnë standardet higjeno-sanitare.
- Objektet kryesore në pjesën më të madhe janë në prona private pa rrugë hyrëse për shërbime mirëmbajtje dhe zëvendësim elektropompash apo transformatorësh.
- Furnizimi me energji elektrike është jashtë standardeve teknike, me shumë luhatje tensioni dhe ka rezultuar që ato të digjen, apo të pësojnë avari të makinerive punuese.
- Faturim e arketimi – pjesor pasi edhe shërbimi i përfituar nuk përmbush standarde të larta cilësie, dhe kohëzgjatja e furnizimit është shumë e ulët.
- Kosto shumë e lartë për tu përballuar me të ardhurat e veta nga UK Shkodër, pa u mbështetur me financim nga Qeveria.
- Asnjë nga njësitë e marra në dorëzim, nuk ka sistem dhe rrjet të largimit të ujërave të përdorura.
- Parashikimi i bazës materiale për operim mirëmbajtjen e këtyre sistemeve është tepër e vështire për UK Shkodër, pasi vështirësohet nga niveli i lartë i amortizimit të tyre dhe mungesës totale të azhornimeve me dokumentacione teknike për llojin e materialeve të instaluara, dimensioneve etj

- Furnizimi me ujë i qytetit të Shkodrës kryhet me ngritje mekanike nga 10 pusë-shpimet që janë në funksion dhe nga 2 stacione pompimi që ndodhen në Dobraç.
  Zonat qe mbulohen nga ky shërbim janë:
  - Qyteti Shkodër
  - Një pjesë e Komunës Rrethina që merr furnizim me ujë nga linjat kryesore të transmetimit të ujit që shtrihen nga Stacioni Pompave në Dobraç direkt për në sistemin shpërndarës
  - Lagjen Bahçallëk me një pjesë të Komunës Bërdicë (zona e Harkut të Bërdicës)

Nga stacioni ujësjellës i Dobraçit furnizohen me ujë rreth 120 000 banorë, ndërsa nga stacioni i Bahçallekut furnizohen rreth 3000 banorë.
Norma standarte e furnizimit me ujë është 150 litër/për një frymë/në ditë. Prodhimi në stinët dimërore është rreth 650 l/s, ndërsa në stinët verore shkon rreth 850 l/s. Konsumi i energjisë për prodhimin e ujit është 1450-1700 kë/orë me kosto 20 000 lek/orë.
Mungesa të shumta për furnizim me ujë nga sistemi ujesjelles shkaktohen nga humbjet per shkak te amortizimit te rrjetit, dëmtimet nga ndërtimet, shtrirja e pjesës më të madhe te rrjetit shpërndares nëpër prona private në qytet, ndërhyrjet e shumta jo profesionale nga banorët e ish-Komunës Rrethina në linjat kryesore, zgjatja e tyre nëpër zona të banuara që arrijnë deri ne Vrakë në shumë zona te qytetit, etj. Zgjatja pa kriter e linjave të hapura private në zonat periferike shkakton prishjen e rregjimit të furnizimit me ujë te qytetit me presionin normal. Nga presioni ulët, klientët detyrohen të instalojnë elektropompa individuale për ngritjen e ujit në katet e sipërme të objekteve duke rritur koston per m³ të konsumuar.
Me investimin e realizuar gjatë periudhës 2011-2015 nga Projekti KFË-së është rehabilituar rreth 11% e linjave të sistemit ujësjellës të qytetit Shkodër.
Nevojat për ndërhyrje me investime për përmirësimin e sistemit ujësjellës janë shumë të mëdha, si në rrjetin shpërndarës të qytetit, ashtu edhe në ndërtimin e rrjetit për zonat informale dhe në linjat kryesore.
Shpenzimet e energjise elektrike per stacionet e pompimit te zonave rurale, vleresohet te jene rreth 26.137.074 lek, ky fakt do te rendoje me teper shoqerine UK me shpenzimet e energjise elektrike per te cilet kerkohet subvencion nga Bashkia Shkoder ne vleren 26.137.074 lek.

ii. Synimi i projektit ( me një fjalë çfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitimi i grupit të synuar)

Garantimi i furnizimit me ujë te pijshëm të popullatës pa ndërprerje.
Rritja e aksesit të popullsisë urbane dhe rurale në furnizimin me ujë të pishëm të sigurtë.

<table>
<tr><td colspan="7">iii. Aktivitetet kryesore të projektit ( Veprimet që do të ndërmerrni për të prodhuar rezultate)</td></tr>
<tr><td colspan="7">Furnizimi pa ndërprerje i popullatës me ujë të pijshëm.<br>Mirëmbajtja e rrjetit të furnizimit me ujë të pishëm nga Ujësjellës Kanalizime Shkodër brenda zonave nën administrim.<br>Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë nga UK Shkodër brenda zonave nën administrim, në shtrirje sa më të gjërë dhe me koston me efikase të mundshme.<br>Ndërtimi i rrjetit të ri të furnizimit me ujë të pishëm si pjesë integrale e projekteve të programit të infrastrukturës rrugore për Buxhetin 2018 të Bashkisë Shkodër .</td></tr>
<tr><td colspan="7">b) Rezultatet që prisni ( shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfituesve të synuar)</td></tr>
<tr><td colspan="7">Zgjerimi dhe përmirsimi i cilësisë së shërbimit të furnizimit me ujë të pishëm në zonat urbane dhe rurale.</td></tr>
<tr><td colspan="3">c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)</td><td colspan="4">d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht etj.)</td></tr>
<tr><td colspan="3">Drejtoria e shërbimit publike dhe Infrastruktures, Sektori i mirembajtjes se infrastruktures<br>Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a<br>Drejtoria Studimeve, Planifikimit, Koordinimit dhe Monitorimit të Investimeve</td><td colspan="4">Bashkia Shkodër<br>Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a</td></tr>
<tr><td colspan="7">e) Shpenzimet e llogaritura ( për cdo aktivitet të mësipërme (pika iii)</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Viti,2018-2020<br>Shpenzimet për cdo aktivitet<br>Kostot për ndërtimin e rrjetit të ri të ujësjellësit përfshihet brenda investimeve për infrastrukturën rrugore (referuar programit të infrastruktures rrugore fishat per Buxhetin 2018-2020).</td><td rowspan="2">Totali (000 lek)</td><td colspan="5">Nga kjo:</td></tr>
<tr><td>Paga</td><td>Sigurime</td><td>Operative</td><td>Subvencion</td><td>kapitale</td></tr>
<tr><td>f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)<br>Gjatë gjithë vitit 2018, 2019 dhe 2020.</td><td colspan="6">g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:<br>Drejtoria e Shërbimit dhe Infrastrukturës, Sektori i Planifikimit të Mirëmbjatjes së Infrastrukturës.<br>Ujësjellës Kanalizime Qytet Shkodër sh.a<br>Drejtoria Studimeve, Planifikimit, Koordinimit dhe Monitorimit të Investimeve</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td>Nr.4</td><td>Projekti. P4. F4. O1. A1<br><br>Menaxhimi i sistemit te ujërave të zeza</td><td>Llojet e programit : P4. Shërbimet Publike<br><br>Funksioni: F4. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura</td></tr>
<tr><td colspan="3">a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</td></tr>
<tr><td colspan="3">i. Situata</td></tr>
<tr><td colspan="3">Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Shkodër, në zbatim të VKM Nr. 63 datë 27.01.2016 ‘’Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura’’, ka vazhduar punën e marrjes në dorëzim gradualisht të sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm, të kanalizimeve të ujërave të zeza dhe të ujërave të shiut, si dhe janë të detyruar të respektojne çdo të drejtë/detyrim që rrjedh prej kontratave të shërbimit.<br>I – Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza për qytetin Shkodër<br>Ky sistem përfshihet nga:<br>- Rrjetin e kanalizimeve të ujrave të zeza të qytetit,i cilipërbëhet prej rreth 150 km tubacione të dimensioneve të ndryshme, me material betoni dhe plastik, dhe rreth 10 000 puseta.<br>- Stacioni i pompave, i cili ndodhet në hyrje të qytetit (Pazar) i cili është rikonstruktuar. Ky stacion bën të mundur pompimin e ujërave të zeza dhe ngritjen e tyre në kuotën e kolektorit shkarkues. Nëpërmjet këtij kolektori shkarkues, me tubacion betoni Ø 1000 mm ujërat e zeza derdhen në lumin Drin.<br>- Pika e shkarkimit të ujërave të zeza e cila ndodhet në krah të djathtë të hyrjes së urës së Bahçallekut, në lumin Drin. Krahas saj shkarkim tjetër (emergjence) i ujërave të zeza bëhet në lumin Buna, nëpërmjet një kanali me tubacion plastik Ø 800 mm, i cili është rikonstruktuar plotësisht. Ky kanal fillon nga stacioni i pompave për në lumin Buna pranë urës së vjetër.<br>- Në kuadër të investimeve të realizuar nga Bashkia në programin e investimeve të vitit 2016-2017, si pjesë e investimit në infrastrukturë është kryer rikonstruksioni i rrjetit të KUZ në këto objekte: blloqe banimi Tepe, Xhabiej, n~ rrugët Bardelit, Isuf Sokoli dhe Qazim Llazani.<br>II - Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza në Shirokë, i cili përfshin:<br>- Stacioni i Shirokës bën të mundur trajtimin e ujërave të përdorura që grumbullohen nga rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza të zonës turistike Shirokë dhe i shkarkon në liqen, duke eliminuar kështu ndotjen e liqenit.<br>III - Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza në Velipojë.<br>Në Maj të vitit 2017, është bërë e mundur të fillohet procesi i inventarizimit të ITUP në Velipojë me shumë vështirësi dhe mungesë të një inventari përfundimtar mbi punimet e fazës së parë, të dytë dhe te trete. Në bazë të dokumentacionit që disponohet dhe sipas situacionit të datës 29.07.2015 (i dorëzuar në CD), janë konstatuar disa mangësi në zërat makineri dhe pjesë rezervë. Nuk kemi asnje informacion zyrtar apo dokumentacionin te dorezuar per orientimin drejt lidhjeve me kanalizimet e ujrave te ndotura, sipas fazave të projektit. Nisur nga këto problematika Ujësjellës Fshat nuk ka pranuar të bëhet pjesë e</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td colspan="5">procesit të transferimit. Aktualisht këto dy sisteme me te gjitha magesite dhe veshtiresite e konstatuara , po punohet intensivisht per nje operim dhe funksionim normal nga UK Shkodër.</td></tr>
<tr><td colspan="5">ii. Synimi i projektit ( me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitimi i grupit të synuar)<br>Rritja e lidhjeve të popullsisë urbane dhe rurale me rrjetet e grumbullimit të ujërave të zeza;<br>Rritja e përqindjes së popullsisë të lidhur me rrjetin e grumbullimit të ujërave të zeza, i cili në rastin e zonës së Shirokës dhe të Velipojës, është i lidhur me një impiant përpunimi të këtyre ujërave të ndotura.</td></tr>
<tr><td colspan="5">iii. Aktivitetet kryesore të projektit ( Veprimet që do të ndërmerrni për të prodhuar rezultate)<br>Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe pusetave;<br>Mirëmbatja e stacioneve të largimit të ujërave të ndotuara;<br>Mbulimi me shërbimin e KUZ nga UK Shkodër brenda zonave nën administrim në qytet dhe Nj.A;<br>Lidhja e abonentëve (familjarë dhe biznes) me kolektorët e rinj të ndërtuar ne rruget dhe blloqet e banimit;<br>Ndërtimi i rrjetit të ri KUZ si pjesë integrale e projekteve të programit të infrastrukturës rrugore për Buxhetin 2018 të Bashkisë Shkodër.</td></tr>
<tr><td colspan="5">b) Rezultatet që prisni ( shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfituesve të synuar)</td></tr>
<tr><td colspan="5">Përmirësim i gjendjes ekzistuese të rrjetit KUZ dhe funksionimi normal i tij;<br>Zgjerimi i rrjetit me KUZ i zonave urbane nga investimeve të parashikuar në buxhetin e Bashkise Shkodër;<br>Rritja e numrit të përfituesve nga shërbimi.</td></tr>
<tr><td>c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)</td><td colspan="4">d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht etj.)</td></tr>
<tr><td>Drejtoria e shërbimive publike dhe Infrastrukturës, Sektori i planifikimit të mirëmbjatjes së infrastrukturës.<br>Sh.a. Ujësjellës Kanalizime<br>Drejtoria Studimeve, Planifikimit, Koordinimit dhe Monitorimit të Investimeve</td><td colspan="4">Bashkia Shkoder<br>Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Shkodër<br>Abonentët (familjarë dhe biznes)<br>Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Qytet Shkodër</td></tr>
<tr><td rowspan="2">e) Shpenzimet e llogaritura ( per cdo aktivitet te mesiperme (pika iii)</td><td rowspan="2">Totali (000 lek)</td><td colspan="3">Nga kjo:</td></tr>
<tr><td>Paga, sig</td><td>operative</td><td>kapitale</td></tr>
<tr><td>f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)<br>Gjatë gjithë vitit 2018-2020.</td><td colspan="4">g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:<br>Drejtoria Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës Sh.a. Ujësjellës- Kanalizime Qytet, Shkodër.</td></tr>
</table>

| Nr.5 | **Projekti P4.F5.O1. A1.**<br><br>Menaxhimi i sistemit të ujërave të bardha (KUB | **Llojet e programit P4.:** Shërbimet Publike<br><br>**Funksioni P4.F5:** Mirëmbajtje e rrjetit të kanalizimit të ujërave të bardha (KUB) |
|---|---|---|
| **a) Përshkrimi i shkurtër i projektit** | | |
| i. Situata ( Shpjego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën) | | |

Gjendja aktuale e sistemi i kanalizimit të ujërave të bardha (KUB)

Sistemi i kanalizimit të ujërave të bardha (shiut), u ndërtua fillimisht si një sistem i veçantë nga rrjeti i kanalizimeve të ujërave të përdorura. Shkodra ka një sistem largimi të ujërave të shiut sipas një sistemi kanalesh të hapura, tombino dhe tubacione ku pjesa më e madhe e ujit të shiut shkarkohet me gravitet në Liqenin e Shkodrës. Disa zona, duke përfshirë edhe zonën industriale, shkarkohen në lumin Kir.

Gjatësia e përgjithshme e sistemit të kanalizimeve për qytetin e Shkodrës është rreth 54 km, nga të cilat, rreth 37 km përbëhet nga tubacione të mbyllura betoni e plastike dhe pjesa tjetër janë kanale të hapura. Kanalet e hapura kanë nevojë për pastrime të herëpashershme, për të siguruar një gjendje të mirë të tyre nga ana hidraulike. Për të ardhmen duhet të mendohet investimi në mbulimin e tyre, pasi gjendja aktuale e tyre është burim hedhjeje e mbeturina inerte dhe të llojeve të tjera nga persona të papërgjegjshëm, duke u shndërruar në rrezik shëndetësor për komunitetet përreth tyre. Pjesa tjetër e kanalizimeve përbëhet nga kanale në gjendje të amortizuar, me karakteristika përcjellje prurje jo të mira. Përveç kësaj, ka dhe shumë kilometra me kanale të vogla kullimi, të cilat kanë nevojë për ridimensionim.

Problematikë tjetër e mprehtë, janë lidhjet e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të përdorura me kanalizimet e ujërave të shiut, që janë bërë ndër vite si rrjedhojë e mungesës së rrjeteve të kanalizimit, apo në mënyrë të njëanshme nga banorët. Këto lidhje, përbëjnë rrezik të dukshëm, sidomos nga përmbytjet gjatë kohës së reshjeve. Vjedhja e kapakëve të pusetave dhe gradelave prej material gize, krijojnë probleme në qarkullim dhe shoqërohet me hedhje të mbeturinave të cilat çojnë në bllokim dhe mosfunksionim të tyre.

Puna e deritanishme tregon për probleme të shumta dhe për nevoja emergjente ndërhyrjeje edhe në sektorin e KUB për zonat rurale.

Aktiviteti punues i sektorit KUB për vitin 2017
Për vitin 2017 janë hartuar plane pune për mirëmbajtjen rutinë të pastrimit të kanaleve të ujërave të shiut, gjithashtu janë realizuar edhe ndërhyrje të paplanifikuara sipas situatave kritike që janë krijuar dhe që rrezikonin përmbytje të zonave të caktuara. Kanalet kryesore të kullimit kanë nevojë për ndërhyrje në pastrimin e tyre me makineri të mëdha, për heqjen e dherave, largimin e mbeturinave dhe prerjen e shkurreve dhe bimësisë përgjatë tyre.

Përveç kanaleve të mëdha kulluese, gjithashtu ka vazhduar puna rutinë në pastrimin e kunetave dhe kanaleve në rrugica të lagjeve të ndryshme të qytetit.

Përveç pastrimeve të kanaleve, është punuar edhe në zëvendësimin e gradelave dhe riparim pusetash të dëmtuara.

**Kostot e aktivitetit punues të sektorit KUB**

Më poshtë paraqitet detajimi i shpenzimeve sipas qëllimit dhe destinacionit.

Përsa i përket pagave dhe sigurimeve shoqërore, llogaritjet për fondin e pagave, janë bërë mbi bazën e organikës së miratuar për vitin 2017 për sektorin e KUB dhe nivelit të pagës së përcaktuar, nga Këshilli i Administrimit i Ujësjellës kanalizime Shkodër. Numri i punonjesve është 19, por duke pasur parasysh zgjerimin e zonës së shërbimit për vitin 2017 parashikohet të rritet nevoja për krahë pune. Nevojat për bazë materiale, janë gjithashtu të larta dhe grupet kryesorë të artikujve për mbulimin me këtë shërbim të të gjithë zonës së shërbimit, janë si më poshtë:

1. Kapake puseta dhe gradela
2. Nafte
3. Prodhime betoni
4. Materiale ndertimi
5. Materiale per zyre

Kapake puseta dhe gradela, ze nje pjese të konsiderueshme, për arsye se përveç zëvendësimeve nga dëmtimet e tyre, duhet të bëhet mbahen në konsideratë edhe vjedhjet e shumta për këto produkte për arsye se ato tregtohen për skrap nga vjedhësit e tyre. Shqetësimi që krijon në qarkullimin e automjeteve dhe të këmbësorëve, na imponon ndërhyrjen e domosdoshme me zëvendesimin dhe vendosjen e kapakëve dhe gradela, në segmentet ku mungojnë. Këtë vit, Dega Teknike, ka menduar që zëvendësimin ta bëjë me kapakë dhe gradela me përbërje të pariciklueshme, për të evituar sa më shumë që të jetë e mundur fenomenin e vjedhjes së tyre.
Nafta është një tjetër artikull me nivel të lartë konsumi. Sektori I KUB ka në përdorim një mjet gërmues, një mjet transporti dhe njërin mjet zbllokues. Automjetet janë të rënda dhe kërkojnë konsum të madh nafte, pasi ato konsumojnë në ecje dhe gjithashtu për orë punë, gjatë pastrimit të kanaleve të hapura të cilat mbushen jo vetëm me mbeturina, por gjithashtu edhe nga

bimësia që rritet në to, duke penguar rrjedhjen e lirë të ujërave.
Prodhimet e betonit dhe materialet e ndërtimit, kryesisht përdoren për zëvendësimet e kapakëve dhe soletave b/a, që mbulojnë shume puseta në blloqe të ndryshme. Gjithashtu riparimi I puseta të dëmtuara, ka nevojë për tulla, blloqe dhe materiale ndërtimi.
Materialet e zyrës , sigurojnë bazën e nevojshme për zhvillimin normal të aktiviteteve të personelit administrativ, të angazhuar për hartimin dhe ndjekjen e planeve të punës së sektorit të kanalizimit të ujërave të bardha.
Bazuar edhe në nevojat në rritje për mbulimin dhe zgjidhjen e problematikave, të sektorit të kanalizimit të ujërave të bardha, edhe për zonat që shtrihen përtej kufinjve të vijës së verdhë të qytetit, shpenzimet e KUB janë rritur në mënyrë të konsiderueshme dhe në bazë të rishikimit të kërkesave për këtë sektor, vlerësohet se niveli i parashikuar i shpenzimeve për vitin 2017 të jetë 12.704.800 lek. Gjithashtu edhe parashikimet për shpenzimet operative të sektorit KUB për vitit 2018, parashikohet të jenë të jenë të larta, kjo si rrjedhojë e rritjes së volumit të punëve dhe mbajtjes në gjendje të mirë të kanaleve të kullimit për evitimin e përmbytjeve të mundshme gjatë rreshjeve atmosferike
Sektori KUB vlerësohet nga UK Shkoder Sh.a, si një sektor, sa i rëndësishëm aq edhe delikat, sidomos në problematikat që krijon në stinët e pranverës, vjeshtës dhe dimrit ku reshjet e shumta që bien në qytetin tonë, krijojnë shpeshherë probleme deri në përmbytje. Tendenca në rritje e kostove të operimit për UK Shkodër, dhe vështirësitë financiare për mbulimin e shpenzimeve operative, si rrjedhojë e zgjerimit të zonës së shërbimit dhe marrjes në dorëzim të sistemeve të KUB për zonën e Velipojës, Bërdicës, etj të cilat gjithashtu kanë problematika të mbartura nga mungesa e mirëmbajtjes, apo investimeve në pjesën më të madhe të tyre, kërkojnë angazhim dhe përpjekje në nivelë akoma më të larta.

Rrjeti i kanalizimeve të ujerave të bardha i qytetit të Shkodrës (për mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut) funksionon i ndarë nga rrjeti i kanalizimeve tëujërave të zeza. Sistemi kryesor i drenazhimit mbulon rreth 70% të zonave formale te qytetit, ndërsa në zonat informale zë një mbulim shumë më të ulët.

Ky rrjet ka një gjatësi prej rreth 54 km, nga të cilat rreth 37 km përbëhet prej tubacioneve të mbyllur betoni e plastik dhe pjesa tjetër janë kanale të hapura:

- Me tubacion betoni nga Ø 200 ÷ Ø 1500 mm
- Me seksione katërkëndëshe betoni të mbyllura, të mbuluara me solet beton arme
- Me seksione katërkëndëshe ose trapezoidale të hapura, të veshura me gurë ose beton
- Me tuba të brinjëzuar Ø 200 ÷ 400 mm

Grykëderdhjet e Kanalizime të Ujërave të Bardha (K.U.B) janë kanale të mëdhenj të hapur:

1. Pjesa veri - lindore e KUB të qytetit ka derdhje në lumin Kir nëpërmjet kanalit të hapur të industrisë (duke filluar që nga shinat e trenit, rruga Qafa e Bishtkazit)
2. Pjesa jug-lindore e KUB te qytetit ka:
   - derdhje në liqenin e Shkodrës nëpërmjet Kanalit të Fermës
   - derdhjë ne lumin Kir nëpermjet grykëderdhjes së rr.Tepe
3. Pjesa perëndimore, me derdhje në livade buzë liqenit të Shkodrës nëpërmjet Kanalit të Zooteknikës dhe Kanalit të QPU–së, si dhe me derdhje në liqenin e Shkodrës nëpërmjet Kanalit të Austriakut
4. Pjesa qëndrore me derdhje në liqenin e Shkodrës, nëpërmjet kanalit të Austriakut me një gjatësi prej 450ml, (pas Prokurorisë së re – Pazar)

Sipas planit të punës, realizohet pastrimi i këtyre kanaleve te hapur (grykëderdhje). Kanalet duke qënë të hapur, bëhen burim i mbledhjes së mbetjeve inerte dhe urbane të hedhura nga njerëz të papërgjegjshëm. Gjithashtu në disa raste, kanalet nuk pastrohen pasi nuk ka mundësi aksesi, si rezultat i objekteve që janë ndërtuar jashte çdo standarti afër dhe mbi kanale, duke sjelle probleme ne funksionim e tij, sidomos gjatë kohës së rreshjeve.
Problem në sektorin e KUB janë edhe vjedhjet e herë pas herëshme të kapakeve dhe gradelave prej gize, duke kaluar kështu edhe kapacitetin e zevendësimit të tyre nga UK Shkodër. Për rrjedhojë, ka mungesë të gradelave nëpër rrugë, duke sjellë kështu mbushjen e KUB me materiale inerte dhe mbeturina.
Mungesa e rrjetit të kanalizimeve KUB në shumë zona të bashkisë Shkodër, ka bërë që gjendja të jetë kritike dhe të vështirsohet kalimi i qytetareve, sidomos në kohë rreshjes, për këtë arsye në projektet e programit të infrastrukturës rrugore për Buxhetin 2017 të Bashkisë Shkodër, është përfshirë edhe ndërtimi i rrjetit të ri KUB si pjesë integrale e projektit që do të mundësoje sistemimin e kanalizimeve të ujerave të shiut.
Bazuar edhe në nevojat në rritje, për mbulimin dhe zgjidhjen e problematikave të sektorit të kanalizimit të ujërave të bardha, edhe për zonat që shtrihen përtej kufinjve të vijës së verdhë të qytetit, shpenzimet e KUB janë rritur në mënyrë të konsiderueshme. Shpenzimet per burimet njerezore arrijne ne vleren 8,711 mije leke, shpenzime te ndryshme operative si kapake puseta dhe gradela, nafte, prodhime betoni, materiale ndertimi, materiale tjera, arrijne ne vleren 10,552 mije leke

ii. Synimi i projektit ( me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitimi i grupit të synuar)

Sigurimi i funksionimit normal të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të bardha (shiut) në qytet dhe grykëderdhjet kryesore për të evituar problematikat e ndryshme, përshirë edhe uljen e mundësisë së përmbytjeve të qytetit.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit ( Veprimet që do të ndërmerrni për të prodhuar rezultate)

Mirëmbajtje e vazhdueshme e kanalizimeve të ujërave të bardha nga UK Shkodër brenda zonave nën administrim.
Pastrimi i pusetave dhe gradelave shi mbajtëse, përfshirë edhe riparimin ose zëvendësimin e pusetave, kapakëve të dëmtuar ose të vjedhur.
Pastrimi i kanaleve kryesore te kullimit dhe nderhyrjet me makineri per heqjen e dherave, largimin e mbeturinave dhe prejen e shkurreve dhe bimesise pergjate tyre.
Ndërtimi i rrjetit të ri KUB si pjesë integrale e projekteve të programit të infrastrukturës rrugore për Buxhetin 2017 të Bashkisë Shkodër.

**b) Rezultatet që prisni ( shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfituesve të synuar)**

Mirëmbajtje e vazhdueshme dhe e qëndrueshme e rrjetit të kanalizimit të ujerave të bardha për zonën e Bashkisë Shkodër.
Evitim i problematikave që mund të çojnë në përmbytje të zonave të caktuara.
Rritja e cilesise dhe sigurise së shërbimit për qytetarët e bashkisë Shkodër, si rezultat i tarifave te reja te miratuara së bashku

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| me investimet kapitale në rrejtin KUB. | | | | | | |
| **c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)** | | **d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht etj.)** | | | | |
| **c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)**<br>Drejtoria e sherbimit publike dhe Infrastruktures, Sektori i planifikimit të mirëmbjatjes së infrastrukturës.<br>Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Shkodër.<br>Drejtoria Studimeve, Planifikimit, Koordinimit dhe Monitorimit të Investimeve. | | Bashkia Shkoder<br>Abonentët (familjarë dhe biznes) | | | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (000 lek) | Nga kjo: | | | |
| | | | Paga, sig | operative | Transferim e | kapital e |
| **A.1** | **Transferim për mbulimin e kostove operativedhe mirëmbajtjes (O&M) së rrjetit KUB.** | **15,000** | | | 15,000 | |
| | **Shuma totale** | **15,000** | | | **15,000** | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2019** | | Totali (000 lek) | Nga kjo: | | | |
| | | | Paga, sig | operative | Transferim e | kapital e |
| **A.1** | **Transferim për mbulimin e kostove operativedhe mirëmbajtjes (O&M) së rrjetit KUB.** | **15,000** | | | 15,000 | |
| | **Shuma totale** | **15,000** | | | **15,000** | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2020** | | Totali (000 lek) | Nga kjo: | | | |
| | | | Paga, sig | operative | Transferim e | kapital e |
| **A.1** | **Transferim për mbulimin e kostove operativedhe mirëmbajtjes (O&M) së rrjetit KUB.** | **15,000** | | | 15,000 | |
| | **Shuma totale** | **15,000** | | | **15,000** | |
| **f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)**<br>Gjatë gjithë vitit 2018-2020. | | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Qytet Shkodër. | | | | |

| Nr.6 | **Projekti :P4.F6.O1.A1-A3**<br><br>Shërbimi Mirembajtjes Varrezave Publike dhe Varrezave të Dëshmorëve. | **Llojet e programit P4 :** Shërbimet Publike<br><br>**Funksioni P4.F6.** Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit; |
|---|---|---|

**a) Përshkrim i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

**Shërbimi i mirëmbajtjes së Varrezave Publike në qytet .**

Gjatë vitit 2017 kemi realizuar mirëmbajtjen e varrezave publike në Bashkinë Shkodër.

Ky shërbim kryhet me sipërmarrje private me kontratë 5-vjeçare e lidhur me date 01.07.2013.
Shërbimet që ofrohen janë:

- Pastrim parcelash dhe rrugësh të mbrendëshme ndërmjet parcelave me sipërfaqe 52.312 $m^2$
- Mbjellje drurësh dekorativ 41 copë.
- Mbjellje në parcela bordurë e gjelbert, 250 $m^2$ .
- Gjithashtu kryhet dhe shërbimi i ruajtjes për varrezat publike dhe ato të dëshmoreve.

Situata e Vlerësuar:

- Nuk ka një Plan veprimi për ofrimin e shërbimit publik të varrezave. Pjesë e shërbimit mungon një rregullore e përditësuar për ofrimin e shërbimit publik të varrezave.
- Shpesh ka vështirësi në administrimin sipas rregullores së funksionimit te varrezave publike, pasi varrezat nuk kanë shpesh rrethim të plotë.
- Ka lëvizje të mjeteve dhe këmbësorëve, ndonjëherë të pa kontrolluar , jo per marrjen e shërbimit ne varreza, por si rruge kalimi.
- Në pjesën më të madhe të njësive, administrimi i varrezave bëhet nga vetë banorët e fshatit apo nga institucione fetare.
- Bashkia Shkodër ka angazhuar punonjes të shërbimeve të varrezave të pajisur me mjete përkatëse për ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave në Njësitë administrative.
- Në ndonjë nga njësitë administrative pjesë e Bashkisë Shkodër, kërkohet vlerësimi dhe planifikimi per shpronësim të hapësirave të reja në funksione të shërbimit të varrezave.
- Nuk ka një tarifë të studiuar për shërbimin publik të varrimit.

**ii. Synimi i projektit**

**Viti 2018 – 2019- 2020**

- Ofrim i shërbimit publik të varrezave në 80 % të territorit administrativ të Bashkisë Shkodër.
- Vazhdim i ofrimit nëpërmjet kontratës me operatorin për Nja Shkodër deri në përfundim të afatit të kontratës.
- Vazhdim i ofrimit të shërbimit në NJA, përmes punonjësve publike të kontraktuar për këtë qëllim.
- Gjatë vitit 2018, që në Janar, Bashkia Shkodër do të fillijë punën për hartimin e planit të veprimit për të ofruar shërbim të standartizuar dhe me indikatorë të matjes së performancës për të gjithë territorin e Bashkisë së Shkodrës.
- Për vitin 2018 e në vazhdim, do të fuqizojë bashkëpunimin me komunitetin, institucionet e besimeve fetare për një mbarëvajte komunitare të këtij shërbimi në te gjithë territorin.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Hartimi i Planit të veprimit dhe rregullores për ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes dhe administrimit të varrëzave.
- Realizimi i proçedurave për realizimin e shërbimit.
- Realizimi i investimeve për krijimin e sipërfaqeve të reja në funksione të shërbimit të varrezave publike.
- Hartim dhe vënie në zbatim e sistemit të monitorimi ti standartizuar ne kuadër të plotësimit të detyrimeve kontraktuale, apo detyrave të përcaktuara për strukturat publike të shërbimit.

**Viti 2019 – 2020**

- Sipas përcaktimeve afatmesme të Planit të veprimit për shërbimin e varrezave:
- Përmirësim i shërbimit të varrezave publike në Bashkinë Shodër.
- Rritje e i investimeve për shërbimin e varrezave publike.
- Përmirësim i përformancës së ofrimit të shërbimit përmes zbatimit dhe funksionimit të sistemit të monitorimit dhe rregullores.

**b) Rezultatet që prisni**

**Viti 2018 - 2020**

- Një plan i saktë veprimi është hartuar, vihet në zbatim me një rregullore për administrimin e shërbimit për një periudhë afatmesme do të hartohet. Ky plan do të analizojë nëvojat, kostot, dhe do të përcaktojë në kohë afatmesme synimet dhe indikatorët e matshëm për përfomancën e ofrimit të shërbimit.
- Ofrim i shërbimit të standartizuar për varrezat publike.
- Rritje sipërfaqeve në funksion të shërbimit të standartizuar të varrezave.
- Rritje e performancës së ofrimit të shërbimit nëpermjët një sistemi më efikas të matjes dhe monitorimit.

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2018 | | Totali ( mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A. 1 | Mirëmbajtje, varreza publike dhe të dëshmorëve Qytet, deri me 1.7.2018 | **3603** | | | 3603 | | |
| A. 2 | Mirëmbajtje varreza publike dhe të dëshmorëve Qytet, (kontrate e re) dhe në NjA | **5446** | | | 5446 | | |
| A. 3 | Karburant per pajisjet e punëtorëve publike në NJësi Administrative. | **960** | | | 960 | | |
| | **Shuma** | **10009** | | | **10009** | | |

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2019 | | Totali ( mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A. 1 | Shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve Qytet, NjA dhe varrezat e dëshmorëve. | **10009** | | | **10009** | | |
| | **Shuma** | **10009** | | | **10009** | | |

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2020 | | Totali ( mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A. 1 | Shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve Qytet, NjA dhe varrezat e dëshmorëve. | **10009** | | | **10009** | | |
| | **Shuma** | **10009** | | | **10009** | | |

| f) Periudha e zbatimit | g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: |
|---|---|
| **1 Janar 2018 deri 31 Dhjetor 2020** | Drejtoria e Shërbimeve Publike;<br>Drejtoria e Buxhetit;<br>Drejtoria e financës;<br>Drejtoria Juridike,<br>Konsulentë mbështetës; |

| Nr. 7 | **P4.F7.O1.A1**<br>Dekorimi i mjediseve publike | **Llojet e programit : P4.** Shërbimet Publike<br>**Funksioni : P4.F7.** Shërbimi i dekorit publik |
|---|---|---|

a) **Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Dekori i mjediseve publike realizohet nga Buxheti i Bashkisë, me mjetet logjistike e fuqinë punëtore të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investime dhe Infrastrukturës. Në strukturën e Drejtorisë janë tre specialistë për dekorin që punojnë me kohë të plotë për realizimin e shërbimit dhe specialistat e ndriçimit që punojnë me kohë të pjesshme për dekorin në rastet e festave. Gjithashtu me kohë të pjesshme për dekorimin e mjediseve vihen në dispozicion edhe 2 autovinçat e ndriçimit në varësi të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investime dhe Infrastrukturës.

Puna që kryhet:
Ky shërbim realizohet kryesisht për dekorimin e qytetit për festat e fund vitit, në rastet e festave të tjera zyrtare si dhe aktivitete të ndryshme të Bashkise gjatë vitit. Sipërfaqja e shesheve dhe e rrugëve të dekoruara në territorin e Bashkisë së Shkodrës është rritur progresivisht nga viti në vit. Pjesa më e madhe e dekorit realizohet me elementë të investuar në vite, të cilët ruhen dhe mirëmbahen nga punonjësit e sektorit. Gjithsej janë gjendje 450 aksesorë zbukurues me të cilët dekorohen sheshet Parrucë, Nënë Tereza, Rus i madh, gjithashtu do të realizohet dekorimi i shëtitoreve rruga 13 Dhjetori, rruga 28 Nëntori, rruga Kol Idromeno si dhe godina e Bashkisë dhe sheshi i saj.
Këtë vit është realizuar blerja zbukurimeve që kanë bërë të munduar shtimin e sipërfaqeve të dekoruar për festat e fundvitit në sheshet kryesore dhe akset kryesore në qendër të qytetit.
Dekori është realizuar dhe për aktivitete tradicionale si 2 Prilli, Dita e Luleve, Dita e Karnevaleve, Festa e Pavarësisë, etj.

Problemet e paraqituara
Në konteksin e ri territorial të Bashkisë Shkodër, lind nevoja për shtrirjen e këtij shërbimi në njësitë administrative të bashkisë si dhe rritja e cilesisë së dekorit urban në të gjitha qendrat dhe sheshet urbane.
Mungesa e dekorit për disa aktivitetet tradicionale.

**ii. Synimi i projektit**

**Viti 2018 – 2019 – 2020**
Përmirësimi i dekorit urban në qytet dhe njësitë administrative, sipas specifikave dhe traditave.
Shtimi i numrit të aktiviteteve duke përfshirë edhe festat e ndryshme fetare me elementë dekorativ.
Shtimi i sipërfaqeve të dekoruara me rastin e festave tradicionale.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

**I.Dekorimi i mjediseve publike**
**Viti 2018**
Janë parashikuar shpenzimet sipas preventivave për dekorin e mjediseve publike për festat e fund vitit, festat e tjera zyrtare si dhe aktivitetet e ndryshme të Bashkisë gjatë vitit.

1. Blerje aksesor dekori për festat:
    - Blerja e aksesorëve shtesë, të cilët do të vendosen në sheshe e rrugë kryesore të Bashkisë. Pjesa tjetër e dekorit do të realizohet me aksesor të blerë në vitet e kaluara, të cilët ruhen e mirëmbahen nga punonjësit e sektorit. Me këto aksesorë për festat e fundvitit do të realizohen dekorimi i akseseve kryesore të rrugëve të qytetit, sheshet Parrucë, Nënë Tereza, Rus i madh, gjithashtu do të realizohet dekorimi i shëtitoreve rruga 13 Dhjetori, rruga 28 Nëntori, rruga Kol Idromeno si dhe godina e Bashkisë dhe sheshi i saj.
    - Gjatë këtij viti për herë të parë parashikojmë dekorimin e ambjenteve publike për festa të ndryshme fetare. Kjo do të realizohet në bashkëpunim me përfaqësuesit e komuniteteve fetare në mbështetje të aktiviteteve që ato zhvillojnë.

2. Blerje materiale të ndryshme për dekorin:
    - Këtu përfshihen materialet e domosdorshme për riparimet e mundshme dhe montimin e aksesorëve të dekorit. Në zërat kryesore të shpenzimeve përfshihen:
    - Kordon ndriçues dekorative (Ø 12 mm) gjithsej 900 ml;
    - Tel percjelles energjie elektrike me dimension 2x1.5 mm gjithsej 900 ml;
    - Lidhëse kabllosh plastike gjithsej 45 kuti;
    - Pistole saldimi plastik gjithsej 2 copë dhe elektroda saldimi plastike gjithsej 480 copë;

3. Blerje flamuj për dekorin e institucioneve administrative në të gjithë territorin si dhe në sheshe dhe rrugë kryesore.
4. Blerje bredha, të cilët do të vendosen në sheshet kryesore

**Viti 2019**
Do të parashikohet blerja e aksesorëve për festat e fundviti, blerje flamuj dhe blerje bredha
**Viti 2020**
Do të parashikohet blerja e aksesorëve për festat e fundviti, blerje flamuj dhe blerje bredha

| **b) Rezultatet që prisni** | |
|---|---|
| **Viti 2018-2019-2020**<br>- Krijimi i dekorit në të gjithë sheshet dhe rrugët kryesore në zonat urbane;<br>- Krijimi i dekorit festiv me rastin e festave zyrtare dhe fetare.<br>- Përmirësim dhe pasurim i dekorit në qytet dhe Njësi administrative | |
| c) Aktorët e mundshëm<br>• Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investime dhe Infrastrukturës.<br>• Administratorët e NjA | d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do tëkontribuojëpërkëtëprojekt, financiarisht, etj.)<br>Bashkia Shkodër<br>Donatoret |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali ( mije lekë) | Nga kjo: Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1.1 | Blerje aksesor dekori për festat | **1500** | | | 1500 | | |
| A.1.2 | Blerje materiale të ndryshme për dekorin | **350** | | | 350 | | |
| A.1.3 | Blerje flamuj | **121** | | | 121 | | |
| | **Shuma** | **1971** | | | **1971** | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2019** | | Totali ( mije lekë) | Nga kjo: Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1.1 | Blerje aksesor dekori për festat. materiale të ndryshme për dekorin, flamuj, etj. | **2000** | | | 2000 | | |
| | **Shuma** | **2000** | | | **2000** | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2020** | | Totali ( mije lekë) | Nga kjo: Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1.1 | Blerje aksesor dekori për festat. materiale të ndryshme për dekorin, flamuj, etj. | **2000** | | | 2000 | | |
| | **Shuma** | **2000** | | | **2000** | | |

| **f) Periudha e zbatimit**<br>Gjatë viti 2018-2020 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës<br>Njësia e prokurimit;<br>Drejtoria e financës;<br>Drejtoria e Buxhetit; |
|---|---|

| Nr. 8 | **Projekti : P4.F8.O1.A1**<br>Shërbimi i Ndriçimit Publik të qytetit dhe njësive administrative në Bashkinë Shkodër | **Llojet e programit: P4.** Shërbimet Publike<br>**Funksioni: F8** Ndriçimi i mjediseve publike |
|---|---|---|
| a) Përshkrimiishkurtëriprojektit: | | |
| i. Situata | | |

Shërbimi i ndriçimit publik të qytetit.

Ndriçimi publik në Qytet, përfshin rrjetin e ndriçimit të shpërndarë si më poshtë:
- ndriçimi i rrugëve kryesore dhe dytësore
- ndriçimi i shesheve
- ndriçimi i parqeve dhe lulishteve

Sipas vlerësimit, sipërfaqja totale e rrugëve dhe e shesheve, arrin afërsisht në 1,600,000 m2, nga të cilat 1,210,000 m2 janë të ndriçuara, ose 75.6 % e sipërfaqes totale, te rrugëve dhe shesheve..
Sipërfaqet e lulishteve dhe brezit të gjelbërt zënë një hapësirë mbi 66,000 m2, nga të cilat 38,000 m2 janë të ndriçuara, ose 58 % e sipërfaqe së gjelbër është e ndriçuar.
Ndriçimi realizohet në një mesatare vjetore 10.5 orë në ditë gjate gjithe vitit.

Asetet në dispozicion të shërbimit të ndriçimit publik për qytetin janë:
- Numri i pikave të furnizimit të energjisë (kabinave elektrike) që kanë kontratë 230 kontrata
- Numri i ndriçuesve të instaluar 4 640 copë

Në territorin urban të qytetit ka 3 lloje shtyllash:
- **dekorative:** të cilat gjenden në zonat pedonale dhe disa nga parqet e qytetit;
- **çeliku:** pothuajse të gjitha të zinkuara, përbëjnë pjesën dominuese të shtyllave që shërbejnë për ndriçimin e qytetit;
- **betoni:** shtyllat i përkasin OSHEE, por ndriçuesit janë të Bashkisë.

**Shërbimi për mirëmbajtjen e rrjetit administrohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve dhe Infrastrukturës. Sektori i shërbimit të mirëmbajtjes të ndriçimit rrugor përbëhet nga:**
**Përgjegjës sektori, një ekonomiste, 7 elektriçistë, 2 shoferë manovratorë vinçi me kosh. Automjetet me të cilën kryhet shërbimi i ndriçimit dhe dekorit janë 2 autovinca**
**Mirëmbajtja realizohet me të ardhurat e Bashkisë, që mbulojnë: shpenzimet për blerje materiale të ndryshme për mirëmbajtjen e rrjetit elektrik, të cilat planifikohen çdo vit, në bazë të preventivave dhe miratohen në buxhetin e Bashkisë.**

Në njësitë e tjera administrative situata e ndriçimit është si më poshtë:
- **Nj.A. Rrethina:** Gjatë vitit 2017 janë realizuar investimet në ndriçimin e fshatit Grudë dhe fshati Bardhaj degëzim. Gjithashtu janë mirëmbajtur dhe janë në efiçencë linjat:Dobraç me 34 ndriçues, Grudë të Re me 12 ndriçues, Lagjja Vinotekë me 8 ndriçues,në fshatin Bardhaj me 15 ndriçues.
- **Nj.A. Bërdicë:** Gjatë vitit 2017 janë realizuar investime në ndriçimin e rrugës Beltojë. Gjithashtu janë mirëmbajtur dhe janë në efiçencë linjat:Trush me 25 ndriçuesa, në Bërdicë e Sipërme me 13 ndriçuesa dhe në Gjo Markaj me 15 ndriçuesa
- **Nj.A. Gur i Zi:** Gjatë vitit 2017 janë realizuar investime në ndriçimin e fshatit Ganjollë.Gjithashtu janë mirëmbajtur dhe janë në efiçencë linjat:Vukatame 35 ndriçuesa, Juban 12 ndriçuesa,Kuç 12 ndriçuesadhe Qendra e Rrencit me 18 ndriçuesa.
- **Nj.A. Postribë:** Gjatë vitit 2017 janë realizuar investimet në ndriçimin e fshatit Drisht dhe fshati Myselim.Gjithashtu janë mirëmbajtur dhe janë në efiçencë linjat:fshati Boks me 4 ndriçuesa, fshatin Dragoç me 4 ndriçuesa dhe fshati Kullaj 3 ndriçuesa
- **Nj.A. Dajç:**Gjatë vitit 2017 janë realizuar investimet në ndriçimin e kryqezimi i Dajcit dhe fshati Pentar.Gjithashtu janë mirëmbajtur dhe janë në efiçencë linjat:Qendra e Dajçit me 18 ndriçuesa, Samrish të Ri me 5 ndriçuesa dhe Mushan me 11 ndriçuesa.
- **Nj.A. Velipojë:** Gjatë vitit 2017 janë realizuar investimet në ndriçimin e rrugës nr 2.Gjithashtu janë mirëmbajtur dhe janë në efiçencë linjat:plazhi Velipojë me 37 ndriçuesa, pedonale me 75 ndriçuesa, rruga hyrëse – lulishtja qendër me 31 ndriçuesa, si dhe rruga nga Qendra deri në Hidrovori me 15 ndriçuesa.

Në zbatim të buxhetit të 2017, me një fond limit prej 8,510,000 lekë është realizuar ndriçimi i dy rrugëve kryesore: rruga”Dr.Ali Spahija” dhe rruga ”Malo Hoxha”, Trush në Nj.A Bërdicë.
Në zbatim të buxhetit të 2017, me një fond limit prej 6,438,000 lekëështë realizuar ndriçimi i 35 rrugëve dytësore:
- Rruga ”Hysen Lohja”,
- Rruga ”Oroshve”,
- Rruga Velej segmenti II,
- Rruga ”Zogaj degëzim,
- Rruga e Muminit,
- Rruga Zabelaj,
- Rruga Ferrukaj,
- Rruga ”Anton Ballaci”,
- rruga Vladimir Jani,

- Rruga Ali Demi (Tepe),
- Rruga Banja e Vogël (kryqëzim),
- Rruga ”Vllaznimi”,
- Rruga ”Arra e Madhe” degëzim,
- Kryqëzimi i Dajçit(NJ.A Dajç),
- rruga Pentar (Nj.A Dajç),
- Rruga Beltojë (Nj.A Bërdicë),
- Rruga fshati Drisht (Nj.A Postribë),
- Rruga fshati Myselim (Nj.A Postribë),
- Rruga fshati Grudë, (Nj.A Rrethina),
- Rruga fshati Bardhaj degëzim, (Nj.A Rrethina),
- Rruga Nr 2 (Nj.A Velipojë)
- Rruga fshati Ganjollë, (Nj.A Gur i Zi).
- Rruga ”Baja e vogël”, dëgëzim
- Rruga ”Mehmet Gjyli”, Draçin
- Rruga ”Populli”
- Rruga ”Sheuqet Muka”
- Rruga ”Qemal Draçini”, Degëzim;
- Rruga ”Shtëpia e Bujqëve”;
- Rruga ”Smakaj”
- Bulevardi ”Skënderbeg”, degëzim;
- Rruga ”Ali Pash Gucia”
- Rruga ”Sarda”
- Rruga ”Treni i Mallnave”
- Rruga ”Fshati Bërdicë”
- Rruga nr.3 Velipojë;

Problemet e paraqituara

- **Dëmtimi i ndriçuesve dekorativ dhe zinkat. Nga aksidentet rrugore dhe amortizimi i ndriçuesvejanë dëmtuar dhe kanë dalë jashtë funksioni shtylla zinkat 8 - 10 m, ndriçues SMART dhe dekorativ si më poshtë:**

| Nr. | Emërtimi | Njësia | Sasia |
|---|---|---|---|
| 1 | Pedonale “13 Dhjetori – 28 Nëntori” (zëvendësim koka ndriçuesish dekorativ) | copë | 12 |
| 2 | Shtylla 8 – 10 m me ndriçues SMART | copë | 25 |

- Mos funksionimi i linjave të ndriçimit të Unazës Lindore dhe rrugës mbikalim Ura e Bardhajve – Mes, të cilat megjithëse kanë përfunduar si investim nuk janë dorëzuar pranë Bashkisë Shkodër në administrim dhe mirëmbajtje.

**Monitorimi:**
Monitorimi i shërbimit realizohet nëpërmjet Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve dhe Infrastrukturës. Evidentimi i defekteve dhe raportimi i tyre pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës bëhet nga njësite administrative dhe punonjësit e ndriçimit publik sipas njësive që ata mbulojnë. Gjithashtu formë tjetër është informimi nga komuniniteti nëpërmjet shkresave apo njoftimeve të ndryshme pranë zyrave të informimit për publikun në çdo Njësi Administrative.

**I. Shpenzimet për pagesat e ndriçimit rrugor për qytetin dhe njësitë administrative**

**Për sektorin e ndriçimit rrugor janë aktualisht 230 kontrata aktive me rreth 4,640 ndriçues në qytet dhe 18 kontrata në njësitë e reja adminitrative. Në fillim të vitit në buxhet parashikohen shuma për pagesën e energjisë elektrike në bazë të fuqisë së instaluar. OSHEE faturon çdo muaj 230 kontratat e furnizimit me energji. Për çdo problem në lidhje me faturimin bëhet verifikimi në terren. Për leximit, për problemet që kontestohen, mbahet proçes-verbali përkatës dhe pastaj ndiqet në rruge administrative dhe gjyqësore. Një herë në vit bëhet akt-rakordimi me OSHEE për të gjitha kontratat e ndriçimit rrugor. Plani i parashikuar për vitin 2017 për pagesën e energjisë së ndriçimit rrugor është 45,000,000 lekë, ndërsa konsumi i energjisë elektrike për qytetin deri në tetor të vitit 2017 është 1,938,774këh ose 32,681,820lekë.**

Në njësitë administrative Velipojë, Dajç, Postribë, Bërdicë dhe Gur iZi konsumi i energjisë elektrike, deri në tetor të vitit 2017, ka qene 176,990 këh e barabarte me 2,989,032 lekë.

**Problemet e paraqituara**

- Faturimet e parregullta ku shpesh paraqiten probleme me mbi faturime, lexim jashtë kushteve teknike,

ii. Synimi i projektit

Mbajtjen në efiçiencë të rrjetit të ndriçimit publik dhe menaxhimin me efektivitet si dhe pagesën për energjinë e shpenzuar nga rrjeti i ndriçimit publik.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

1. **MIRËMBAJTJE E RRJETIT ELEKTRIK.**

**Viti 2018**
Shpenzimet për mirëmbajtjen e rrjetit elektriktë ndriçimit publik janë parashikuar në bazë të preventivave të hartuar, për ndërhyrje rehabilituese dhe riparimin e defekteve, në të gjitha rrugët, sheshet, blloqet e banimit dhe lulishtet. Parashikimi për bazën materiale për mirëmbajtje është bërë duke u bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara, ndërhyrjet rehabilituese për ndriçues të dalë jashtë përdorimi, zëvendësimi i kabllove të vjedhuara në vitet e fundit, amortizimi i ndriçuesve nga orët e punës që kanë 5 vjet garanci , pjesa me e madhe e tyre e kanë kaluar këtë periudhe.

1.1 **Materiale për ndërhyrje rehabilituese**. Këtu përfshihen zëvendësimi i ndriçuesve dekorativ dhe zinkat, të dëmtuar: Pedonale "13 Dhjetori – 28 Nëntori" (zëvendësim koka ndriçuesish dekorativ) 12 copë dhe shtylla 8 – 10 m me ndriçues SMART 25 copë.

**1.2 Materiale për mirëmbajtje e rrjetit të ndriçimit publik gjatë vitit**
**Këtu përfshihen shpenzimet për materiale e domosdoshme, për riparimin e difekteve të mundshme të ndriçuesve. Në zërat kryesore të shpenzimeve përfshihen:**

- **Automatë të madhësive të ndryshme 10 A deri 63 A, gjithsej 800 copë. Këto automate do i përdorim për riparim e difekteve gjatë vitit, si dhe për dekorimin e qytetit me rastin e festave të fund vitit , ku çdo ndriçues kërkon një automat të veçantë,**
- **Drosel ndriçuesi 250 ë dhe 150 ë, gjithsej 1 620 copë**
- **Kabëll elektrik të madhësive 2x2.5, 2x4, 2x6, 3x6,4x4,4x6, 2x6 koksial, mm2 , gjithsej 10 850 ml për eliminimin e difekteve nga dëmtimet gjatë viti**
- **Lëshues të kapacitetit 25A deri 40A, gjithsej 430 copë.**
- **Llampa SAP 150 ë, gjithsej 1 530 copë dhe 250 ë, gjithsej 270 copë**
- **Llampa fuoriesçente 22 ë gjithsej 430 copë,**
- **Rele krepuskolare modulare, 16/30 gjithsej 115 copë**
- **Rele krepuskolare për shtyllë, 12/25, gjithsej 115 copë**
- **Portollampa për llampa SAP 150 ë, gjithsej 100 copë**
- **Portollampa porcelani për llampa elektronike 22 ë, gjithsej 170 copë**

**Evidentimi i difekteve bëhet nga specialistët e punonjësit e sektorit të ndriçimit publik, nga punonjësit e njësive adminsitrative dhe kërkesat e qytetarëve.**

2. **PAGESAT E FATURAVE TË NDRIÇIMIT PUBLIK PARASHIKOHEN:**

**Viti 2018**
2.1 Pagesa për konsumin e energjise elektrike për 230 kontratat në qytet.
2.2 Pagesat për konsumin e energjisë elektrike për kontratat e reja që do hapen pas realizimit të investimeve të vitit 2017
2.3 Pagesat për konsumin e energjise elektrike për kontratat nga investimet e reja gjatë vitit 2017 në njësite e reja adminsitrative
2.4 Pagese tarife pranë OSHEE për hapjen e kontratave të reja në qytet dhe njësite administrative ku janë realizuar investimet në vitin 2017 dhe ato që do të reazlohen në vitin 2018
2.5 Për pagesën e ekspertit në rast të kundërshtimit të faturave të energjisë të ndriçimit rrugor në rrugë gjyqësore

Theksojmë në njësitë administrative deri në fund të vitit nuk kanë paguar tarifë shërbimi për ndriçimin publik. Pas përfundimit të investimeve në rrugët e Nj.A të viteve 2016-2017 do të propozojmë që aty ku ofrohet ky shërbim të filloj pagesa e tarifës së shërbimit.

**Monitorimi**
Funksionimi i sistemit të kontrollit të rrjetit të ndriçimit publik dhe evidentimi i difekteve nëpërmjet punonjësve të sektorit të ndriçimi publik, njësive adminitrative dhe komunitetit;
Verifikimi në terren i kontratave të ndriçimit rrugor për faturat e kontestueshme;
Ndekja e proçedurave administrative dhe gjyqësore;
Ndekja e proçedurave për lidhjen e kontratave të reja nga specialisti përkatës;

**Shpenzime të ndryshme viti 2018**

3 **BLERJE VEGLA PËR ELEKTRIÇISTA**
Blerje vegla pune për punonjësite sektorit të ndriçimi publik si për shembull:(sonda, pinca, shkallë, dalta etj)

4 **FURNIZIM VENDOSJE PJESË KËMBIMI DHE MIRËMBAJTJE E MAKINERIVE**
Në funksion të mirëmbajtjes së ndriçimit dhe dekorit, janë 2 autovinçat tip

a. IVECO
b. NISSAN ,

për të cilët parashikojmë këto shpenzime për pjesë këmbimi. Në zërat kryesor mund të përmendim: pjesë këmbimi si ndërrim filtra vaj, ajri, nafte, ndërrim vaj motorri, ndërrim goma, ndërrim vaj hidraulik si dhe riparime të ndryshme të paparashikueshme që mund të ketë gjatë vitit.
Në funksion të mirëmbajtjes së ndriçimit dhe dekorit janë 2 autovinçat tip

a. IVECO, në zërat kryesor mund të përmendim: mirëmbajtje të zakoshme si ndërrim filtra vaj, ajri, nafte, ndërrim vaj motorri, ndërrim goma, riparim hidraulik i vinçit, riparim pompe nafte, saldimi i koshit si dhe riparime të ndryshme të paparashikueshme që mund të ketë gjatë vitit.
b. Për autovinçin NISSAN, në zërat kryesor mund të përmendim: mirëmbajtje të zakoshme si ndërrim filtra vaj, ajri, nafte, ndërrim vaj motorri, ndërrim goma, riparim hidraulik i vinçit, riparim pompe nafte, saldimi i koshit si dhe riparime të ndryshme të paparashikueshme që mund të ketë gjatë vitit.

Për secilin nga këto autovinça është hartuar preventivi përkatës i pjesë të këmbimit e mirëmbajtjes.

5. **SHPENZIME PËR KARBURANT PËR 2 AUTOVINÇAT.**

Në bazë të normativave të llogarituara parashikohen që për secilin mjet konsumi të jetë 3960 litra në vit me një mesatare prej 330 litra në muaj për secilin mjet. Për të dy autovinçat parashikohen 7920 litra në vit.

a. IVECO 3 960 litra
b. NISSAN 3 960 litra

**6. PAGESA PËR DOKUMENTACIONIN E MJETEVE (2 AUTOVINÇAT)**

Për secilin mjet parashikojmë shumën që na nevojitet për pagesën e siguracionit, taksave dhe kolaudimit

a. Autovinçi IVECO
b. Autovinçi NISSAN

7. **INVESTIME**

**Viti 2018**

**Investime në rrugë kryesore:**

Do të realizohet studim, projektim dhe zbatim në rrugën Fermentim – Ura e Bardhajve, me gjatësi deri 1 100 ml. Ndriçimi do të realizohet me shtylla ndriçimi.

**Investimet në ndriçimin e rrugëve dytësore:**

Me këtë investim do të realizohet ndriçimi në disa rrugica të qytetit dhe njësive administrative, sipas prioriteteve dhe mundësive teknike, për vendosjen e ndriçuesve. Me ketë investim do te realizohet ndriçimi publik me vendosjen e 120 ndriçuesve në rrugë të ndryshme sipas prioriteteve në qytet dhe në njësitë administrative. Ndriçimi do të realizohet, duke shfrytëzuar aty ku është e mundur, shtyllat ekzistuese dhe linjat ekzistuese, gjë që ul kostot.

Gjatë vitit 2018 parashikojmë që me anë të investimevtë realizojmë zbatimin e metodave të reja të efiçiencës së energjisë si një model i mirë, inovatim dhe me reduktim të dukshëm të kostove.

Shpenzimet e planifikuara për ndërhyrjet në vitin 2018

| | |
|---|---|
| **Blerje materiale rehabilituese për mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues** | **16,000,000** |
| **Pagesa e konsumit të ndriçimit** | **52,850,000** |
| **Te tjera** | **3,101,000** |
| **Investime** | **18,216,000** |
| **TOTAL** | **90,167,000** |

Mbulimi i kostove të shërbimit të ndriçimit për vitin 2018 përllogaritet si më poshtë:

| **Familjet** | **Nr.i familjeve përfituese të shërbimit** | **Nr. i mesatarizuar i familjeve që paguajnë (jane hequr familjet me lehtësi fiskale)** | **Tarifa e ndriçimit** | **Të ardhurat nga tarifat e ndriçimit** |
|---|---|---|---|---|
| Rrethinat | 4,901 | 3,676 | 300 | 1,102,800 |
| Postribë | 1,609 | 947 | 300 | 284,100 |
| Shalë | 477 | | | |
| Pult | 334 | | | |
| Shosh | 80 | | | |
| Guri I Zi | 1,907 | 1,297 | 300 | 389,000 |
| Ana Malit | 1,017 | 717 | 300 | 215,100 |
| Bërdicë | 1,425 | 1,023 | 300 | 306,900 |
| Dajç | 1,152 | 871 | 300 | 261,300 |
| Velipojë | 1,270 | 982 | 300 | 294,600 |
| Shkodër | 21,253 | 15,781 | 1,200 | 18,937,200 |
| TOTAL | | | | **21,791,000** |

| | |
|---|---|
| Të ardhurat nga biznesi | **12,351,000** |
| Të ardhurat nga institucionet | **125,000** |
| **<u>TOTALI I TË ARDHURAVE TË PLANIFIKUARA</u>** | **<u>34,267,000</u>** |

**Burimet e financimit për shërbimin ndriçimit rrugor**




Planifikimi për Vitin 2019 dhe Vitin 2020
**Janë parashikuar shpenzimet për mirëmbajtjen e rrjetit elektrik dhe materiale për ndërhyrje rehabilituese. Do të realizohet blerje e materialeve të ndyshme të domosdoshme, për mirëmbajtjene rrjetit elektrik si: automata, drosela, kabëll elektrik, lëshues, llampa, rele krepuskolare, portollamapa, etj**
Janë parashikuar shpenzimet, për pagesën e energjisë elektrike, për hapjen e kontratave të reja, për pagesën e ekspertit, në rast të kundërshtimit të faturave të energjisë të ndriçimit rrugor në rrugë gjyqësore
Janë parashikuar shpenzimet për:

- Blerje vegla për elektriçista (materiale konsumi)
- Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi për autovinçat
- Blerje karburant
- Pagesa për dokumentacion e autovinçat, etj.

Do të bëhet rehabilitimi i disa rrugëve të reja kryesore të qytetit me ndriçues LED. Ndërtim i ndriçimit publik në 3,700 ml rrugë dytësore po me ndriçim LED me reduktim kostoje.

b) Rezultatet që prisni

**Viti 2018**
Mirëmbajtja e gjithë rrjeti i ndriçimit publik në rrugë kryesore, dytësore në të gjithë Bashkinë:

- 1,210,000 m2 sipërfaqe e ndriçuar e mirëmbajtur;
- 38,000 m2 sipërfaqe e gjelbëruar e ndriçuar e mirëmbajtur
- Mirëmbajtje e 4,640 ndriçuesve të zakonshëm;
- Mirëmbajtje e 118 ndriçuesve dekorativ;

Realizimi i lidhjes të kontratave të reja në qytet dhe njësitë administrative për 35 rrugë të reja të ndriçuara gjatë vitit 2017;
Realizimi i pageses për konsumin e pritshëm të energjisë elektrike (50, 000,000 lekë) për të gjitha kontratat në qytet dhe njësitë administrative;
Realizimi i ndriçimit publik në 1,100 ml rrugë kryesore;
Realizimi i ndriçimit publik në 4,100 ml rrugë dytësore të reja në qytet dhe në njësi administrative.
Rritje e sipërfaqes së ndriçuar në qytet nga 1’210’000 m2 në në 1,241,200, nga 75 % sipërfaqe rrugësh e ndriçuar në rritjen në 77.7 % sipërfaqe e ndriçuar;

**Viti 2019**
Mirëmbajtja e gjithë rrjeti i ndriçimit publik në rrugë kryesore, dytësore në të gjithë Bashkinë
Zëvendësimi ndriçuesve dekorativ dhe shtyllave metalike
Zëvendësimi i ndriçuesve të dalë jashtë përdorimit
Realizimi i lidhjes të kontratave të reja në qytet dhe njësitë administrative
Realizimi i pageses për konsumin e pritshëm të energjisë elektrike për të gjitha kontratat në qytet dhe njësitë administrative
Realizimi i ndriçimit publik në 3,700 ml rrugë dytësore;
Rritja e efiçencës nëpërmjet vendosjes së ndriçuesa LED;

**Viti 2020**
Mirëmbajtja e gjithë rrjeti i ndriçimit publik në rrugë kryesore, dytësore në të gjithë Bashkinë
Zëvendësimi ndriçuesve dekorativ dhe shtyllave metalike
Zëvendësimi i ndriçuesve të dalë jashtë përdorimit
Realizimi i lidhjes të kontratave të reja në qytet dhe njësitë administrative
Realizimi i pageses për konsumin e pritshëm të energjisë elektrike për të gjitha kontratat në qytet dhe njësitë administrative
Realizimi i ndriçimit publik në 3,000 ml rrugë dytësore
Rritja e efiçencës nëpërmjet vendosjes së ndriçuesa LED

| c) Aktorët e mundshëm | d) Kontributet e mundshmenëprojekt |
|---|---|
| Punonjësit e sektorit të ndriçimit<br>Banorët e qytetit dhe njësive të reja administrative;<br>Qytetarët;<br>Bizneset; | BashkiaShkodër |

| Institucionet e tjera si OSHEE, etj. | |
|---|---|

e) Shpenzimet e llogaritura

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2018 | | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1.1 | | **Blerje materiale rehabilituese për mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues** | **16,000** | | | 16,000 | | |
| A.1.2 | | **Pagesa e konsumit të ndriçimit** | **52,850** | | | | | |
| | A.1.2/1 | Pagesa e konsumit të ndriçimit publik (ekzistues +zgjerim) sipas faturimit OSHEE Bashkia Shkodër (qyteti dhe njësitë administrative) | | | | 52,000 | | |
| | A.1.2/2 | Kosto për lidhje kontrate me OSHEE qytet e njësite e tjera | | | | 700 | | |
| | A.1.2/3 | Shërbimeekspertipërp roçesegjyqësore | | | | 150 | | |
| A.1.3 | | **Blerje vegla pune për elektriçista** | **400** | | | 400 | | |
| A.1.4 | | **Furnizim vendosje pjesë këmbimi dhe mirëmbajtje e makinerive** | **1,200** | | | **1,200** | | |
| A.1.5 | | **Shpenzime për karburant për autoviçant** | **1,374** | | | 1,374 | | |
| A.1.6 | | **Pagesa për dokumentacionin** | **127** | | | | | |
| | A.1.6/1 | Pagesa siguracion për autovinçin IVECO | | | | 37 | | |
| | A.1.6/2 | Pagesa siguracion për autovinçin NISSAN | | | | 24 | | |
| | A.1.6/3 | Pagesa për taksa e kolaudim për autovinçin IVECO | | | | 24 | | |
| | A.1.6/4 | Pagesa për taksa e kolaudim për autovinçin NISSAN | | | | 42 | | |
| A.1.7 | | **Investime** | **18,216** | | | | | |
| | A.1.7/1 | Studimproje ktimInvestim errugëdytës ore | | | | | | 267 |
| | A.1.7/2 | ZbatimInves timerrugëdyt ësore | | | | | | 6 000 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | A.1.7/3 | Mbikëqyrjek olaudim | | | | | | 171 |
| | A.1.7/4 | Zëvendësimi i ndriçuesve të dëmtuar (dekorativ + zinkat) | | | | | | 2093 |
| | A.1.7/5 | Shtesë ndriçuesish tek shtyllat ekzistuese në rrugën Martin Camaj | | | | | | 840 |
| | A.1.7/6 | Studim projektim Ndriçimi i rrugës Fermentim – Ura e Bardhajve | | | | | | 524 |
| | A.1.7/7 | Zbatim Ndriçimi i rrugës Fermentim – Ura e Bardhajve | | | | | | 8,000 |
| | A.1.7/8 | Mbikëqyrje Ndriçimi i rrugës Fermentim – Ura e Bardhajve | | | | | | 300 |
| | A.1.7/9 | Kolaudim Ndriçimi i rrugës Fermentim – Ura e Bardhajve | | | | | | 21 |
| | | **Shuma 2018** | **90,167** | | | **71,951** | | **18,216** |

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2019 | | Totali ( mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| | **Shuma 2019** | **91,408** | | | **72,951** | | **18,457** |

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2020 | | Totali ( mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| | **Shuma 2020** | **92,624** | | | **73,798** | | **18,826** |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)**<br>Gjatë vitit 2018 – 2020 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës |

| Nr.9 | **Projekti:P4.F9.O1.A1**<br>**Shpenzime për pagat, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative përpunonjësit e ShërbimevePublike** | **Llojet e programit:P4 Shërbimet Publike** |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

i. Situata

- **Paga dhe shtesat për punonjës mbështetes shërbimi, mirëmbajtje, pastrim, heqje mbeturina urbane, roje**

Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli, do të bazohet tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë, në përputhje me aktet nën ligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Paga, shtesat mbi pagat e punonjësve, bëhen sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165 datë 02.03.2016 " Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", duke u bazuar ne sistemin me klasat e pershtatur sipas VKM nr 717, datë 23.6.2009 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore", të ndryshuar.

Planifikimi I fondit te pagave dhe sigurimeve shoqerore per vitin 2017, eshte ne shumen 33,077 mije leke, nga te cilat 28,538 paga dhe 4,539 sigurime shoqerore.

Duke qene se ka gjendje leke te paperdorura nga viti 2017, ne planin e vitit 2017 pagat dhe sigurimet shoqerore, do të paraqiten per diference paga 1,000 mije leke

- **Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetesore**

Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetesore do të jetë në zbatim të ligjit Nr. 7703, datë 11. 05. 1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 7870, date 13. 10. 1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".

- **Kompensim për kryefamiljarët me ngarkesë me më shumë se tre persona në ngarkim**

Sipas VKM Nr. 499, dt 13.08.1998, VKM. Nr. 683 dt 28.10.1988 dhe udhëzimit të M.P.Ç.Sociale, nr 3311, dt 24. 12. 1998, të punësuarit në sektorin buxhetor përfitojnë shpërblim sipas rastit

  - Shërbimi për kryerjen mirëmbajtjen e rrjetit a dministrohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve dhe Infrastrukturës. Sektori i shërbimit të mirëmbajtjes të ndriçimit rrugor përbëhet nga: punonjesit e shërbimit te ndriçimit, dekorit, sinjalistikës, mirëmbajtjes së objekteve në administrim të Bashkisë, punonjësve të shërbimeve të Nj.A. Për realizimin e funksioneve të punonjëve kërkohet fuqëzimi me materiale dhe mjete pune.

ii. Synimi I projektit

Garantimi I shpenzimeve të pagave, sigurimeve shoqerore dhe shëndetësore të punonjësve të shërbimeve publike

Përmbushja e nevojës për kryerjen e shërbimeve ditore të ruajtjes, pastrimit, mirëmbajtjes dhe të tjera, për objektet dhe hapësirat publike.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Sigurimi I shpenzimeve

1. Paga,
2. Sigurime shoqërore dhe shëndetësore, për adminsitratën vendore
3. Kompensime
4. Blerje material të ndryshme për punonjësit e njësisë së ofrimit të shërbimeve, si për shembull: (furça, elektroda, komplet punta hekuri, maskë saldimi, punta betoni,dalta, traponi matrapik, etj)
5. Paisje me dokumentin e sigurimit teknik për punonjësit e njësisë së ofrimit të shërbimeve
6. Blerje mjete të ndryshme për punonjësit e njësisë së ofrimit të shërbimeve , si për shembull: (Gurfleksibël, motorsekë, Indikator valor, Sopatë, Kit – Trapon matrapik me bateri, etje)

**b) Rezultatete pritshme**

Shpërblimi në mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore dhe shëndëtsore të administrates vendore në mbështetje të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparencë.

Efektivitet të plotëtë punës së punëtorëve të njësisë së ofrimit të shërbimeve

Mirëmbajtja e të gjithë objekteve në qytet dhe në Nj.A

Mirëmbajtje e ambjenteve publike në Nj.A

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| 1. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse<br>2. Drejtoria e Financës | Bashkia Shkoder |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për cdo aktivitet viti 2018** | | Total (000 lek) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigur ime | operativ e | Transf erta | Kapitale |
| A.1.1/1 | Paga dhe shtesat mbi paga | 27 | 27 538 | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 538 | | | | | |
| A.1.1/2 | Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetesore | 4 539 | | 4 539 | | | |
| A.1.1/3 | Kompensime për kryefamiljarë me ngarkesë më shumë se 3 fëmije | 180 | | | | 180 | |
| A.1.2/1 | Blerje materiale të ndryshme për punonjësit e njësisë së ofrimit të shërbimeve | 800 | | | 800 | | |
| A.1.2/2 | Paisje me dokumentin e sigurimit teknik për punonjësit e njësisë së ofrimit të shërbimeve | 60 | | | 60 | | |
| A.1.3 | Blerje mjete të ndryshme për punonjësit e njësisë së ofrimit të shërbimeve | 400 | | | | | 400 |
| **TOTALI** | | **33,517** | **27 538** | **4 539** | **860** | **180** | **400** |
| **Shpenzimetpërcdoaktivitetviti 2019** | | | | | | | |
| A.1.1/1 | Paga dhe shtesat mbi paga | **29 108** | 29 108 | | | | |
| A.1.1/2 | Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetesore | **4 631** | | 4 631 | | | |
| A.1.1/3 | Kompensime për kryefamiljarë me ngarkesë më shumë se 3 fëmijë | **180** | | | | 180 | |
| **TOTALI** | | **33 919** | 29 108 | 4 631 | | **180** | |
| **Shpenzimetpërcdoaktivitetviti 2020** | | | | | | | |
| A.1.1/1 | Paga dhe shtesat mbi paga | **29 691** | 29 691 | | | | |
| A.1.1/2 | Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetesore | **4 722** | | 4 722 | | | |
| A.1.1/3 | Kompensime për kryefamiljarë me ngarkesë më shumë se 3 fëmijë | **180** | | | | 180 | |
| A.1.2/1 | Blerje materiale të ndryshme për punonjësit e njësisë së ofrimit të shërbimeve | 400 | | | 400 | | |
| **Totali** | | **34 993** | 29 691 | 4 722 | **400** | **180** | |

**f) Periudha e zbatimit**

Gjatë vitit 2018-2020

**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**

1. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse
2. Drejtoria e Financës

| Nr. 10 | **P4.F9.O1.A2. Hartimi i planeve të veprimit per sherbimet publike** | **Llojet e programit:P4 Shërbimet Publike** |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Bashkia Shkodër në zbatim të Ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve publike si: shërbimi i pastrimit, shërbimi i gjelbërimit, shërbimi i ndriçimit publik, shërbimi i mirëmbajtjes së rrjetit të kanaleve kulluese dhe vaditëse, mirëmbajtja e rrugëve, e infrastrukturës së institucioneve të arsimit parashkollor dhe shkollor, etj.

Për herë të parë në vitin 2017, me qëllim përmirësimin e shërbimit, Bashkia Shkodër ndërmori iniciativën për realizimin e Planit të Veprimit për përmirësimin e shërbimit të kullimit, si një dokument për analizën, planifikim afatmesëm, dhe për matjen e përformancës së ofrimit të shërbimit.
Pas reformës territoriale, lind nevoja për nja administrim sa më të mirë të burimeve, me efketivitet dhe efiçiencë, sipas prioriteteve dhe nevojave të vlerësuara nga qytetarët dhe teknicienët.
Plan i veprimit për përmirësimin e një shërbimi të caktuar public hartohet bazuar në metodologjinë e punës në grup dhe përmes një procesi pjesëmarrës. Ky proces realizohet përmes procsit të përshruar më poshtë.

- Ngritja e grupit të punës për hartimin e dokumentit
- Analiza e situatës aktuale të shërbimit, infrastrukturës, etj.
- Baza ligjore dhe institucionale;
- Përshkrimi i gjendjes
- Të dhëna teknike dhe specifikime të shërbmit;
- Shtrimi i problemeve;
- Përshkrimi i përgjithshëm dhe qëllimi i planit të veprimit për përmirësimin e shërbimit
- Vlerësimi me vëzhgues të kualifikuar rezultatet e vlerësimit të shërbimit me anketa (pyetsor) me qytetarët;
- Kapacitete lokale për ofrimin e shërbimit (mirëmbajtje, apo investim);
- Misioni ,objektivat dhe aktivitetet e planit të veprimit për shërbimin;
- Komunikimi me publikun

Plani i veprimit për përmirësimin e shërbimit është dokument që shërben si një instrument shumë i rëndësishëm për menaxhimin me cilësi , efiçencë dhe efikasitet të shërbimit publik.

Ky dokument përcakton gjithaështu edhe metodën e manaxhimit te performances, matjes së rezutateve nepermjet indikatorëve si dhe mundëson alokimin e buxhetit përmes një procesi dhe vendimarrje me pjesëmarrje.

Në vitin 2018, Bashkia Shkodër parashikon hartimin e Planit të veprimit për përmirësimin e disa shërbimeve publike si: shërbimi i gjelbërimit, shërbimi i mirëmbajtjes së infrastrukturës së objekteve shkollore, shërbimi i mirëmbajtjes së rrugëve, shërbimi i ndriçimit, etj.

Nga ekpserienca e realizuar gjatë hartimit të planit të veprimit për përmirësimin e shërbimit të kullimit në Bashkinë Shkodër, ky process realizohet për një periudhë 1-2 mujore.
Bashkia Shkodër do të angazhojë stafin e vet sipas përgjegjësisë,specialistët dhe drejtuesit e niveleve përgjegjës, drejtor, nënryetar dhe kryetar, përfaqësuesit e komunitetit, të rinjtë, pse jo edhe student të universitetit të Shkodrës. Ky proces do të kërkojë edhe mbështetjen me ekspertizë rreth 15-20 dite punë për proceset e trajnimit, mbështetjen në ëorkshope apo seminare teknike, si dhe përpunimin e të dhënave.

**ii. Synimi i projektit**

- Hartimi i një plani/planeve të qartë afatmesëm veprimi për përmirësimin e shërbimit publik/shërbimeve publike;

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Ngritja e grupeve të punës
2. Trainim 2 ditor per parimet dhe metoden e SIAP. ( mund te behet ne nje dite te gjate)
3. Pergatitje format raportimi ( ku ti jepet detyra e radhes per analizen e situates si pas fomatit dhe metodologjise , radhes, elementeve perberes etj)
4. Pergatitje e tabelave financiare dhe te produktit ( disagregimi i te dhenave dhe ndarja sipas struktures raportuese,)
5. Shtrimi dhe analiza e problemeve
6. Vendosja e rezultateve qe do arrihen dhe indikatoret mates
7. Mision, vizion, objektiva si dhe vendosja e objektivavae te financimit , klidhja me produkt si dhe llogaritjet e eficences.
8. Formatimi i pyetesoreve (per qytetaret dhe vezhguesit e kualifikuar)
9. Mbledhja dhe perpunimi dhe agregimi i te dhenave
10. Plani veprimit
11. Organizimi i komunikimit me publikun;
12. Tabela perfundimtare dhe me anekset për katëse;
13. Diskutimi dhe konsultimi përfundimtar nga këshilli i Bashkisë Shkodër;
14. Miratimi i Planeve të veprimit për përmirësimin e shërbimeve dhe rregulloreve përkatëse. dhe në Këshillin Bashkiak;

| b) Rezultatet që prisni |
|---|
| • Hartimi i një plani/planeve të qartë afatmesëm veprimi për përmirësimin e shërbimit publik/shërbimeve publike;<br>• Rritje e përformancës në menaxhimin dhe ofrimin e shërbimit;<br>• Proces me pjëesëmarrje për hartimin e planit-analiza – misioni-vizioni-objektivat e matshëm-prioritetet e aktiviteteve-burimet e financimit;<br>• Sistem i qëndrusehëm për raportimin dhe monitorimin e shërbimeve publike;<br>• Komunikim transparent me publikun;<br>• Minimizim i korrupsionit të mundshë, si një rrisk në administratën publike;<br>• Përvetësimin e metodologjisë së punës nga ana e administratës së angazhuar në Bashkinë Shkodër;<br>• Rritje e kapaciteteve të administrimit të shërbimit të administratës me përgjegjësi dhe të angazhuar në process |

| c) Aktorët e mundshëm | d) Kontributet e mundshme në projekt |
|---|---|
| Drejtoria e Shërbimeve publike, ndjekjes së Investimeve dhe Infrastrukturës<br>Drejtoria Ekonomike e Arsimit,<br>Drejtoria e Buxhetit;<br>Drejtoria e Financës;<br>etj: sipas fushës përkatës të shërbimit publik dhe nevojës për bashkëpunim, | Bashkia e Shkodrës<br>Ekspertë të fushës; |

e) Shpenzimet e llogaritura ( për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali ( mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Subv | Kapitale |
| A.1 | Ekpsertë të fushës (honorar 2700lekë/ orë) | **540** | | | 540 | | |
| **Shuma 2018** | | **540** | | | **540** | | |

| **f) Periudha e zbatimit**<br><br>Viti 2018 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br><br>Nënryetarët sipas fushës së përgjegjësisë;<br><br>Drejtoritë përkatëse sipas fushës së përgjegjësisë së shërbimit; |
|---|---|